# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5837
E premte, 26 korrik 2019
çmimi 0.40 €

## Presidenti javën e ardhshme nis konsultimet me partitë politike

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ENDRIT SHALA FAQE 4-5



# Nisma Socialdemokrate në këto zgjedhje do t'ia prishë shumëkujt kalkulimet

- Rezultati i Nismës Socialdemokrate në këto zgjedhje do të jetë dyshifrorë, mbi 10 për qind

Sekretari për marrëdhënie me publikun i Nismës Socialdemokrate, Endrit Shala, ka bërë me dije se pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj rruga e vetme janë zgjedhjet e reja parlamentare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se ky subjekt politik në këto zgjedhje do t'i marrë mbi 10 për qind të votave. Shala, i cili është edhe ministër në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë, ka treguar se në rritjen e Nismës Socialdemokrate ka ndikuar puna e mirë e ministrave të kësaj partie që kanë bërë në dikasteret e tyre dhe aktiviteti i deputetëve të saj në Kuvend. Shala ka thënë se personalisht mendon se Nisma Socialdemokrate duhet të shkojë e vetme në këto zgjedhje. Ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate nuk ka vija të kuqe për asnjë subjekt politik

SOT (E PREMTE) BËHET NJË VIT NGA VDEKJA E VEPRIMTARIT TË ÇËSHTJES KOMBËTARE, ADEM DEMAÇI

# NJË VIT PA BACËN ADEM

Një vit më parë ka ndërruar jetë veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i cili tërë jetën ia kishte kushtuar kombit shqiptar, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Në nderim të jetës dhe veprës së Demaçit sot (e premte) në orën 12:00 Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë e Kosovës do të organizojnë një akademi përkujtimore, e cila do të mbahet në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Një ditë para se t'i mbushë një vit vdekja e Bacës Adem, presidenti Hashim Thaçi ka bërë homazhe te varri i tij në Prishtinë FAQE 3



## Qytetarët ndihen të kërcënuar nga grabitjet

FAQE 7

## OPINION

### IKU NJË VIT KUR KALOI NË PËRJETËSI BACA I MADH, ADEM DEMAÇI

F. 11



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

### EHHHH, BAC!

F. 12



Merita Shasivar Makolli

## AKTUALE

### UJËSJELLËSI 'PRISHTINA' SIGURON QYTETARËT PËR CILËSI TË UJIT TË PIJSHËM

F. 9



## EKONOMI

### FOL-I ME PLATFORMË ONLINE PËR KRAHASIMIN E PASURISË PËR 500 ZYRTARË PUBLIKË

F. 9

## SPORT



### ZEKA: KUALIFIKIMI ËSHTË OBLIGIM I FERONIKELIT

F. 16

### HAJRIZI: JAPIM MAKSIMUMIN NË ÇDO NDESHJE

F. 16

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: OSBE-ja të ndërmjetësojë për zgjidhjen e krizës politike në vend

TIRANË, 25 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, i kërkoi të enjten sekretarit të përgjithshëm të OSBE-së, Thomas Greminger, ndërmjetësimin sa më parë të jetë e mundur midis palëve politike në vend për zgjidhjen e krizës politike në vend. "Rruga e vetme është dialogu politik gjithëpërfshirës dhe i sinqertë që i jep zgjidhje të plotë e përfundimtare kësaj krize", tha Meta gjatë takimit me sekretarin e përgjithshëm të OSBE-së, Thomas Greminger.
Presidenti Meta e falënderoi për mbështetjen e dhënë nga Sekretariati dhe nga vetë sekretari i përgjithshëm për përgatitjet që Shqipëria po bën në funksion të marrjes së kryesisë së radhës së OSBE-së në vitin 2020. "Kjo është sipërmarrje madhore, që kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjithë faktorëve politikë dhe institucionalë në vend", tha presidenti Meta.



# Në Kosovë 38 000 fëmijë me aftësi të kufizuar nuk vijojnë shkollimin

Sipas statistikave të fundit të publikuara nga MAShT-i, numri i përgjithshëm i nxënësve me aftësi të kufizuar fizike të verifikuar është 5 294, nga të cilët 41 për qind janë vajza dhe 59 për qind janë djem




PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Vlerësohet se rreth 43 000 fëmijë me aftësi të kufizuara në gjithë Kosovën do të duhej të ishin në shkollë më 1 shtator kur hapen dyert e shkollave. Megjithatë, vetëm rreth 5 300 prej tyre vijojnë mësimet në shkollat e rregullta.
Fiona është një vajzë 13-vjeçare me aftësi të kufizuar e cila jeton në Fushë-Kosovë dhe për të ky vit do të jetë i veçantë pasi ajo do të kthehet në shkollë pas plot tre vjetësh larg bankave shkollore. E gjithë kjo është bërë e mundur falë zyrtarëve komunalë të arsimit të cilët kanë gjetur zgjidhjen për Fionën dhe shumë fëmijë të tjerë me aftësi të kufizuar, që të përgatiten për vitin e ardhshëm shkollor 2019.
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP) dhe shef i Zyrës së UNMIK-ut, Zahir Tanin, ka lansuar anketën e UNICEF-it të më shumë se 5 000 të rinj nga e gjithë Kosova, duke i pyetur ata mbi perceptimin e tyre për bërjen e arsimit të qasshëm dhe gjithëpërfshirës për fëmijët siç është Fiona. UNICEF-i përdori platformën e tij "U Report", e cila është në dispozicion përmes "Facebook"-ut dhe "Viber"-it dhe ku të rinjtë shprehin mendimet e tyre dhe shërbejnë si agjentë pozitivë të ndryshimit në komunitetet e tyre.
Janë pyetur më shumë se 5 000 të rinj nga e gjithë Kosova mbi perceptimin e tyre për bërjen e arsimit të qasshëm dhe gjithëpërfshirës për fëmijët siç është Fiona.
Për këtë është përdorur platforma sociale "U-Report", e krijuar nga UNICEF-i.
59 për qind e të rinjve iu përgjigjen pyetësorit duke shprehur perceptimin e tyre se: Shoqëria në Kosovë përgjithësisht nuk është gjithëpërfshirëse. Po ashtu, 39 për qind e të rinjve identifikuan mentalitetin përjashtues të shoqërisë si barriera më e madhe për gjithëpërfshirjen. Barrierat e tjera përfshinin mungesën e përfitimeve në para (22 për qind), mungesën e shërbimeve (14 për qind), mungesën e legjislacionit dhe politikave gjithëpërfshirëse (14 për qind). Kërkesa më e madhe e të rinjve nga institucionet e Kosovës është ofrimi i asistentëve personalë në shkolla (33 për qind). Të rinjtë besojnë se ofrimi i një kurrikule të përshtatur për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuar (30 për qind), pajisjet ndihmëse, përfshirë karrocat (17 për qind), transporti për në shkollë pa pagesë (15 për qind) dhe fizioterapia (5 për qind), do ta përmirësonin edhe më shumë qasjen në arsim. Të rinjtë, po ashtu, identifikuan mbështetjen më të madhe për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar si: mbështetja financiare (34 për qind), mbështetja nga komuniteti (24 për qind) dhe shërbimet profesionale dhe trajnimet.
Sipas statistikave të fundit të publikuara nga MAShT-i, numri i përgjithshëm i nxënësve me aftësi të kufizuar fizike të verifikuar është 5 294, nga të cilët 41 për qind janë vajza dhe 59 për qind janë djem. Fakti që aftësia e kufizuar duhet të verifikohet për t'u njohur është problem, pasi mund të ketë më shumë fëmijë me vështirësi emocionale dhe vështirësi në të nxënit që kanë nevojë për mbështetje shtesë në shkollë, por nuk janë të verifikuar. Gjatë vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara zakonisht merret për bazë një model mjekësor, duke përjetësuar idenë se ata kanë probleme që duhet të rregullohen nga profesionistët shëndetësorë, në vend se të trajtohet mënyra se si mund të mbështetet secili fëmijë për t'i tejkaluar barrierat që i kufizojnë ata në shoqëri apo se si shoqëria duhet të përshtatet për ta lehtësuar jetën e tyre, në mënyrë që edhe ata të mund t'i gëzojnë të drejtat e tyre.
Shefi i Zyrës së UNICEF-it në Prishtinë, Murat Sahin, i fton institucionet Kosovës që të ndajnë burime të mjaftueshme për punësimin dhe trajnimin e më shumë mësimdhënësve dhe asistentëve, duke ofruar mbështetje shtesë për pajisje dhe hapësira të specializuara dhe përfundimisht duke lehtësuar hyrjen e personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës.

## Hahn: Të vazhdojnë reformat në Maqedoninë e Veriut

SHKUP, 25 KORRIK - Maqedonia e Veriut e meriton që në tetor ta marrë dritën e gjelbër për nisjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka thënë në Shkup, komisionari për Zgjerim i BE-së, Johannes Hahn. Megjithatë, ai tha se për të realizuar këtë është e domosdoshme që Maqedonia Veriore të vazhdojë t'i zbatojë reformat, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit, duke miratuar Ligjin mbi prokurorinë publike dhe luftën e pakompromis kundër korrupsionit dhe krimit. "Shtetet anëtare do të monitorojnë nga afër procesin, por të gjitha ato që po bëhen janë kryesisht për të mirën e qytetarëve. Sundimi i ligjit është thelbësor që ata të kenë besim në institucionet, por edhe se vendi është i qëndrueshëm, politikisht dhe ekonomikisht", ka thënë Hahn në një konferencë shtypi pas takimit me kryeministrin maqedonas Zoran Zaev. "Është koha që BE-ja t'i përmbushë detyrimet e saj ndaj Maqedonisë së Veriut", shtoi Hahn. Ai përmendi marrëveshjen mes Shkupit dhe Athinës për çështjen e emrit si një të arritur të madhe për Maqedoninë e Veriut.
Në anën tjetër, kryeministri Zoran Zaev u shpreh i bindur se në tetor vendi do ta marrë datën e nisjes së negociatave për anëtarësim në BE.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Sot (e premte) bëhet një vit nga vdekja e veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi

# NJË VIT PA BACËN ADEM

Një vit më parë ka ndërruar jetë veprimtari i çështjes kombëtare, Adem Demaçi, i cili tërë jetën ia kishte kushtuar kombit shqiptar, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Në nderim të jetës dhe veprës së Demaçit sot (e premte) në orën 12:00 Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë e Kosovës do të organizojnë një akademi përkujtimore, e cila do të mbahet në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Një ditë para se t'i mbushë një vit vdekja e Bacës Adem, presidenti Hashim Thaçi ka bërë homazhe te varri i tij në Prishtinë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 25 KORRIK - Sot (e premte) bëhet një vit nga vdekja e veprimtarit të çështjes kombëtare shqiptare, Adem Demaçi. Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Bacës Adem, Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës dhe Shoqata e ish të Burgosurve Politikë e Kosovës në orën 12:00 do të mbajnë një akademi përkujtimore në Bibliotekën Kombëtare "Pjetër Bogdani" në Prishtinë.

Një ditë para përvjetorit të parë të vdekjes së Bacës Adem, presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë homazhe te varri i tij në Prishtinë. Pas homazheve, Thaçi ka thënë se Demaçi do të nderohet dhe përkujtohet gjithmonë nga shteti i Kosovës. Me këtë rast, Thaçi e ka quajtur Bacën Adem si baba të pavarësisë së Kosovës. "U mbush një vit pa simbolin e rezistencës kombëtare, Adem Demaçin, njeriun i cili gjithë jetën e vet ia kushtoi lirisë, pavarësisë dhe ndërtimit të shtetit të Kosovës, njeriu i orientimit euroatlantik dhe, mund të themi lirisht, edhe themeluesi dhe babai i pavarësisë së Kosovës. Vlera, kontributi dhe angazhimi i Adem Demaçit do të nderohen dhe do të kujtohen gjithmonë nga shteti i Kosovës, sikurse edhe sot. Në të njëjtën kohë do të jetë një vlerë e respektuar dhe e vlerësuar lart nga i gjithë kombi shqiptar, sikurse që do të jetë i vlerësuar gjithmonë dhe në përjetësi nga bota demokratike", ka thënë Thaçi.

Presidenti Thaçi ka deklaruar se Adem Demaçi u shërben për marrjen e energjive të reja në konsolidimin e shtetit të Kosovës drejt perspektivës euroatlantike dhe ruajtjes së raporteve të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). "Çdo nderim për Adem Demaçin është nderim për sakrificën e të gjithë atyre njerëzve që kanë rënë për lirinë e Kosovës, për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për vuajtjet e kaluara në burgjet e kazamatet serbe dhe në të njëjtën kohë është marrje e energjive të reja që të lëvizim edhe më shpejt në konsolidimin e brendshëm dhe të jashtëm të shtetit tonë në perspektivën e sigurt për në NATO, Bashkim Evropian dhe raporte të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)", ka deklaruar Thaçi.

Baca Adem Demaçi ndërroi jetë më 26 korrik të vitit 2018, ndërsa ishte varrosur me nderime të larta shtetërore më 28 korrik. Po më 27 korrik Kuvendi i Kosovës mbajti një seancë përkujtimore në nderim të jetës dhe veprës së Demaçit. Në ceremoninë e varrimit të tij kishin marrë pjesë personalitetet kryesore të jetës politike, kulturore dhe akademike nga të gjitha trevat shqiptare.

Adem Demaçi ka qenë i burgosur politik. Ai kishte mbajtur 28 vjet burgim në kazamatet serbe për shkak të kauzës kombëtare. Baca Adem Demaçi në vitin 1991 ishte nderuar nga Parlamenti Evropian me çmimin "Sakharov". Demaçi në vitin 1998 ishte zgjedhur përfaqësues politik i UÇK-së, ku kishte hapur zyrën në Prishtinë. Ndryshe, Adem Demaçi njihet edhe si "Gandi i Ballkanit". Përpos veprimtarisë kombëtare, Demaçi ka lënë pas edhe krijimtarinë publicistike.

# Presidenti në javën e ardhshme nis konsultimet me partitë politike

Presidenti Hashim Thaçi nga java e ardhshme do t'i nisë konsultimet me partitë politike për ndërmarrjen e hapave të mëtejmë që çojnë në tejkalimin e situatës së krijuar nga dorëheqja e kryeministrit Ramush Haradinaj. Të gjitha partitë politike kanë shprehur gatishmërinë e tyre për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Madje ato janë shprehur edhe kundër formimit të një qeveri teknike



EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 25 KORRIK - Zyra për media e Presidencës së Kosovës ka njoftuar të enjten se presidenti Hashim Thaçi, pas dorëheqjes së kryeministrit të Republikës së Kosovës, do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në pajtim me kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. "Mandati kushtetues i presidentit të Republikës së Kosovës është i pacenueshëm për të siguruar respektim të parimit të ndarjes së pushteteve dhe për ta ruajtur sigurinë e rendit juridik dhe kushtetues në vendin tonë. Për më tepër, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese, presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit dhe është garantues i funksionimit demokratik të institucioneve shtetërore. Prandaj, çdo hap që do të ndërmarrë presidenti do të jetë në përputhje vetëm me interesat e qytetarëve dhe interesat shtetërore", është thënë në njoftimin për media të Zyrës së Presidencës.

Më tej në njoftim thuhet se: "Presidenti i Republikës së Kosovës i siguron gjithë qytetarët se çdo veprim i tij do të jetë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe duke filluar nga java e ardhshme do t'i filloje konsultimet me partitë politike/koalicionet për ndërmarrjen e hapave të mëtejmë që çojnë në tejkalimin e situatës së krijuar nga dorëheqja e kryeministrit".

Më 19 korrik Ramush Haradinaj dha dorëheqje nga pozita e kryeministrit, pasi që ishte ftuar nga Prokuroria Speciale e Dhomave të Veçanta në Hagë, për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Nga ai moment të gjitha partitë politike kanë shprehur gatishmërinë e tyre për zgjedhje të parakohshme parlamentare. Madje ato janë shprehur edhe kundër formimit të një qeveri teknike, duke e ftuar presidentin e vendit, Hashim Thaçi, që t'i fillojë sa më parë konsultimet me partitë për caktimin e datës së zgjedhjeve.

Flet për "Epokën e re", Endrit Shala

# Nisma Socialdemokrate në këto zgjedh

## - Rezultati i Nismës Socialdemokrate në këto zgjedhje do të jetë dyshifrorë, mbi 10 për qind



Sekretari për marrëdhënie me publikun i Nismës Socialdemokrate, Endrit Shala, ka bërë me dije se pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj rruga e vetme janë zgjedhjet e reja parlamentare. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur i bindur se ky subjekt politik në këto zgjedhje do t'i marrë mbi 10 për qind të votave. Shala, i cili është edhe ministër në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë, ka treguar se në rritjen e Nismës Socialdemokrate ka ndikuar puna e mirë e ministrave të kësaj partie që kanë bërë në dikasteret e tyre dhe aktiviteti i deputetëve të saj në Kuvend. Shala ka thënë se personalisht mendon se Nisma Socialdemokrate duhet të shkojë e vetme në zgjedhje. Ai ka thënë se Nisma Socialdemokrate nuk ka vija të kuqe për asnjë subjekt politik

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 26 korrik** - Sekretari për marrëdhënie me publikun i Nismës Socialdemokrate, Endrit Shala, është shprehur i bindur në rezultate të mira të këtij subjekti politik në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Ai ka thënë se shifrat e Nismës në zgjedhjet e parakohshme që pritet të mbahen së shpejti do të jenë dyshifrore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ministri në detyrë i Tregtisë dhe Industrisë ka thënë se ky subjekt është rritur fuqishëm. "Ne jemi të bindur se Nisma Socialdemokrate do të dalë jashtëzakonisht mirë në këto zgjedhje. Ashtu siç kemi deklaruar edhe më herët, Nisma Socialdemokrate është një subjekt i cili është duke u rritur jashtëzakonisht shumë. Në këtë mënyrë besoj dhe jam i bindur se Nisma Socialdemokrate do të dalë aq mirë sa do t'ia prishë kalkulimet shumëkujt, të atyre që kanë dyshime në rezultatet e këtij subjekti politik. Besoj se rezultati i Nismës Socialdemokrate në këto zgjedhje do të jetë dyshifrorë", ka thënë Shala.

Ai ka treguar se në këtë rritje të Nismës Socialdemokrate ka ndikuar puna e mirë që ministrat e kësaj partie kanë bërë në dikasteret që kanë udhëhequr dhe aktiviteti i deputetëve të saj në Kuvend. "Natyrisht se këtu ka ndikuar puna e madhe që ka bërë Nisma Socialdemokrate në këtë mandat qeverisës, sidomos në dikasteret që janë udhëhequr nga ky subjekt politik. Po ashtu, ndikim ka pasur edhe aktiviteti i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate në Kuvend dhe i gjithë zyrtarëve të Nismës në secilën degë të saj në Kosovë. Pra, kjo punë e madhe ka bërë që t'i shtyjnë qytetarët e Kosovës të mendojnë dhe t'ia japin një besim edhe më të madh Nismës Socialdemokrate", është shprehur ai.

Shala ka thënë se personalisht mendon se Nisma Socialdemokrate në këto zgjedhje duhet të shkojë e vetme, megjithatë ai thotë se për këtë do të vendosin organet partiake. Personalisht mendoj se Nisma Socialdemokrate kësaj here duhet të shkojë e vetme në këto zgjedhje. Mirëpo për këtë çështje ende nuk kemi ndonjë vendim të organeve partiake. Kjo mbetet të shihet në ditët e ardhshme. Qëndrimi im personal është se duhet të shkojmë të vetëm në zgjedhje, mirëpo vendimin përfundimtar për këtë do ta marrin organet e Nismës Socialdemokrate", është shprehur Shala.

"Epoka e re": Z. Shala, si e ka pritur Nisma Socialdemokrate dorëheqjen e kryeministrit Ramush Haradinaj?

Shala: Ashtu edhe siç kemi deklaruar, dorëheqja e kryeministrit Haradinaj ka qenë një veprim për të cilin ne si partner të koalicionit nuk kemi qenë të informuar deri kur ai e ka bërë publike. Pavarësisht prej kësaj, ne tashmë jemi në një situatë të re dhe si Nismë Socialdemokrate jemi duke i bërë të gjitha përgatitjet për zgjedhjet e reja ashtu siç e parashikojnë ligjet në fuqi.

**"Epoka e re":** *Pra, Nisma Socialdemokrate është e gatshme për zgjedhje të reja parlamentare?*

**Shala:** Ne jemi gati për këto zgjedhje kurdo që presidenti i vendit, në konsultim me partitë politike, i shpall ato. Pra, do ta respektojmë cilëndo datë që do ta caktojnë institucionet e Republikës së Kosovës.

## Rreth 400 bashkatdhetarë, për dy ditë, kanë vizituar Kuvendin e Kosovës

**Prishtinë, 25 korrik** - Bashkatdhetarët, të cilët po qëndrojnë për pushime në Kosovë, për dy ditë radhazi kanë vizituar Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili, nën moton "Bashkatdhetarët në Kuvend", ka hapur dyert për ta. Me këtë rast, rreth 400 bashkatdhetarë nga vende të ndryshme të Evropës dhe botës janë pritur nga deputetë të grupeve të ndryshme parlamentare me të cilët kanë bashkëbiseduar për tema të ndryshme, me theks të veçantë për fuqizimin e rolit të tyre si dhe për mundësinë e krijimit të lehtësirave në Kosovë. Po ashtu, ata janë njohur nga afër nga punëtorët e administratës me punën, funksionin dhe rolin e Kuvendit.

Bashkatdhetarët janë shprehur të kënaqur për mundësinë që u është ofruar për t'i vizituar hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.



# je do t'ia prishë shumëkujt kalkulimet



"Epoka e re": *Kushtetuta tani parasheh edhe mundësinë që koalicioni aktual të mund ta nominojë një kandidat tjetër për kryeministër. A pajtohet Nisma Socialdemokrate me një skenar të tillë?*
**Shala:** Ajo që dua të them është se pas dorëheqjes së kryeministrit është krijuar një situatë e re politike në vend. Me dorëheqjen e kryeministrit, i cili ka qenë mandatar i shumicës parlamentare në Kosovë, vendi duhet të shkojë në zgjedhje me qëllim që t'ia kthejmë edhe një herë mandatin qytetarit, sovranit, që të vendosë për përbërjen e re të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili më pas do ta zgjedhë qeverinë e re.

"Epoka e re": *Si pritni që të dalë Nisma Socialdemokrate pas këtyre zgjedhjeve të reja?*
**Shala:** Ne jemi të bindur se Nisma Socialdemokrate do të dalë jashtëzakonisht mirë në këto zgjedhje. Ashtu siç kemi deklaruar edhe më herët, Nisma Socialdemokrate është një subjekt i cili është duke u rritur jashtëzakonisht shumë. Në këtë mënyrë besoj dhe jam i bindur se Nisma Socialdemokrate në këto zgjedhje do të dalë aq mirë sa do t'ia prishë kalkulimet shumëkujt, sidomos atyre që kanë dyshime në rezultatet e këtij subjekti politik. Besoj se rezultati i Nismës Socialdemokrate në këto zgjedhje do të jetë dyshifrorë.

"Epoka e re": *Që i bie se synoni mbi 10 për qind të votave?*
**Shala:** Mbi 10 për qind. Në vitin 2014 ne kemi dalë njëfarë 'surprize' sepse në shumë tavolina është diskutuar nëse Nisma mund ta kalojë pragun. Prandaj, mund t'ju them se në këto zgjedhje Nisma Socialdemokrate po hynë shumë e fuqishme dhe jemi të bindur se do të marrim përkrahje shumë të madhe nga qytetarët. Se sa i besojnë Nismës Socialdemokrate qytetarët, kjo mund të shihet vetëm në muajin e fundit ku mbi 2 000 anëtarë të rinj iu bashkuan familjes sonë politike. Pra, dyert e Nismës do të jenë gjithmonë të hapura për njerëz me ide dhe energji pozitive.

"Epoka e re": *Çfarë mendoni se ka ndikuar në rritjen e besimit ndaj këtij subjekti politik?*
**Shala:** Natyrisht se këtu ka ndikuar puna e madhe që ka bërë Nisma Socialdemokrate në këtë mandat qeverisës, sidomos në dikasteret që janë udhëhequr nga ky subjekt politik. Po ashtu, ndikim ka pasur edhe aktiviteti i grupit parlamentar i Nismës Socialdemokrate në Kuvend dhe i gjithë zyrtarëve të Nismës në secilën degë të saj në Kosovë. Pra, kjo punë e madhe ka bërë që t'i shtyjnë qytetarët e Kosovës të mendojnë dhe t'ia japin një besim edhe më të madh Nismës Socialdemokrate.

"Epoka e re": *Pretendoni të shkoni vetë në këto zgjedhje apo të bëni ndonjë koalicion parazgjedhor?*
**Shala:** Personalisht mendoj se Nisma Socialdemokrate këtë herë duhet të shkojë e vetme në këto zgjedhje, mirëpo për këtë çështje ende nuk kemi ndonjë vendim të organeve partiake. Kjo mbetet të shihet në ditët e ardhshme. Qëndrim im personal është se duhet të shkojmë të vetëm në zgjedhje, mirëpo vendimin përfundimtar për këtë do ta marrin organet e Nismës Socialdemokrate.

"Epoka e re": *Sa janë gjasat që sërish të kemi një koalicion parazgjedhor PDK-AAK-Nisma?*
**Shala:** Edhe një herë po e përsëris, se pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj, i cili ka qenë mandatar i PAN-it për ta bërë qeverinë, kemi një situatë të re politike në vend. Kjo situatë e re politike nënkupton organizimin e zgjedhjeve të reja parlamentare. Kurse, pas zgjedhjeve mund t'i shohim të gjitha mundësitë për bashkëqeverisje, varësisht prej rezultateve.

"Epoka e re": *Pas zgjedhjeve a do të ketë vija të kuqe Nisma Socialdemokrate për ndonjë subjekt politik?*
**Shala:** Nisma Socialdemokrate nuk ka vija të kuqe për asnjë subjekt politik në Kosovë. Ne presim që pas rezultateve zgjedhore organet e partisë të vendosin për mundësitë e bashkëqeverisjes në mandatin e ardhshëm.

## QKUK-ja së shpejti me rezonancë të dytë dhe CT të re

Prishtinë, 25 korrik (ER) - Pacientët që kanë nevojë për shërbime të rezonancës magnetike dhe CT-së këto shërbime do t'i marrin më lehtë në Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK). Ata më nuk do të kenë nevojë për pritje, përderisa imazhet e ofruara do të jenë të kualitetit të lartë. Qendra Klinike Universitare e Kosovës pritet që së shpejti të pajiset me rezonancën e dytë magnetike dhe me një tomografi të kompjuterizuar (CT). Furnizimi me këto aparatura do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së shërbimeve dhe do ta ulë listën e pritjes për këto shërbime, duke krijuar qasje shumë më të lehtë për pacientët.






# Ehhhh, Bac!



Merita Shasivar Makolli

Sipas kalendarit, sikur sot, një vit më parë, ende merrje pak nga fryma e kësaj bote, e ne të tjerët vazhdonim ta vidhnim frymën tënde.
Të nesërmen kishe mbyll sytë, o GJIGAND!
Me motivin më egoist nxitova pa frymë me ta prek ballin, ma ta puth atë ballë që ende ishte i nxehtë. Shfrytëzova edhe një herë fatin me të pa nga afër.
Po qysh na le, o BAC?
Nuk ka mundësi të kesh shkuar e as të kesh vdekur.
Po si mund të vdesë ADEM DEMAÇI, bre!
Më ka rastisur të dëgjoj një shkencëtar të thotë se edhe pas vdekjes shpirti ekziston, por ne nuk kemi kapacitete ta shohim.
Nuk kishim sy për të të parë edhe kur ishe i vizualizuar, e lëre më t'i kemi kur ekzistenca jote mori trajtë tjetër.
Kam dëgjuar dhe lexuar se Zoti i do njerëzit e vet qindra e mijëra herë më shumë sesa që e do nëna fëmijën e vet dhe se ne, pavarësisht prej asaj dashurie, nuk e duam dhe nuk e dëgjojmë udhëzimin e tij.
Bac, më fal për këto fjalë dëshpërimi, por nuk jemi TI, prandaj edhe ankohemi, dorëzohemi, vuajmë dhe dergjemi të shtrirë…
Dështuam për t'u kapur për dorën tënde. Humbëm RASTIN E MADH!

**(25 korrik 2019)**

# Qytetarët ndihen të kërcënuar nga grabitjet

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar të enjten Edicionin Special të Barometrit Kosovar të Sigurisë: Trendët e perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë (2016-2018). Të anketuarit ndihen më të kërcënuar nga grabitjet tani sesa gjatë dy vjetëve të mëparshëm



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 KORRIK - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar të enjten Edicionin Special të Barometrit Kosovar të Sigurisë: Trendët e perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë (2016-2018). Siguria është një e drejtë themelore e njeriut. Ndjesia e sigurisë apo e pasigurisë ndikon fuqishëm në shëndetin fizik dhe mendor dhe mirëqenien e qytetarëve dhe mund të çojë në rritjen e besimit/mosbesimit, çka ndikon në socializimin e qytetarëve dhe ndjenjën e komunitetit. Si rrjedhojë, QKSS-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë perceptimeve të qytetarëve në lidhje me sigurinë publike dhe sigurinë personale, që nga viti 2012 kur u lansua për herë të parë Barometri Kosovar i Sigurisë.

Ky edicion i posaçëm i BKS-së ofron një përmbledhje të perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë gjatë tre vjetëve të fundit. Më konkretisht ai nxjerr në pah trendët e perceptimit mbi sigurinë publike, duke u fokusuar në të dhënat e Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) të mbledhura gjatë periudhës 2016-2018.

Të dhënat e mbledhura gjatë kësaj periudhe u përqendruan në shqetësimet dhe problemet kryesore të të anketuarve me sigurinë publike, si dhe në masat që duhen ndërmarrë për ta përmirësuar sigurinë publike në Kosovë.

Elemente të ndryshme ndikojnë në perceptimet e qytetarëve në lidhje me sigurinë publike. Pa dyshim se qëndrimet e tilla formësohen nga përvoja personale. Megjithatë, nuk mund të injorohet rëndësia e mediave dhe rrjeteve sociale për formësimin e opinioneve të qytetarëve.

Perceptimet mund të lidhen me karakteristikat personale të tilla si mosha, gjinia, përkatësia etnike, arsimi dhe gjendja ekonomike. Prandaj, përtej analizave të përgjithshme të të dhënave, ky edicion përfshin edhe analiza të kryqëzuara të kërcënimeve të ndryshme të sigurisë publike me karakteristika personale.

### Rreziqet dhe kërcënimet kryesore ndaj komunitetit në Kosovë

Ka një rritje të të anketuarve që i perceptojnë vrasjet si kërcënim kyç për sigurinë publike; Të anketuarit që jetojnë në zona urbane i perceptojnë vrasjet si një rrezik më të madh se qytetarët që jetojnë në zonat rurale; Të anketuarit ndihen më të kërcënuar nga grabitjet tani sesa gjatë dy vjetëve të mëparshme; Të anketuarit në zonat urbane ndihen më të kërcënuar nga grabitjet sesa qytetarët në zonat rurale; Fajdet po rriten me shpejtësi si kërcënim i perceptuar; Më pak se gjysma e të anketuarve e shohin rritjen e dhunës në shkolla si kërcënim për sigurinë publike; Më shumë se gjysma e të anketuarve i perceptojnë aksidentet e trafikut si kërcënim të lartë; Ka një rritje lineare të perceptimit të dhunës në familje si kërcënim të madh; Ka një rritje të qartë të perceptimit të dhunës në familje si kërcënim nga të dy gjinitë dhe të anketuarit e rinj janë më të shqetësuar për dhunën në familje; Barometri ka shënuar një rritje të perceptimit të ngacmimeve seksuale si kërcënim të lartë të sigurisë publike. Megjithatë, shumica e qytetarëve nuk e perceptojnë ngacmimin seksual si rrezik të sigurisë publike; Më shumë se gjysma e të anketuarve i shohin kafshët endacake si kërcënim për sigurinë publike.

### Trendët e perimetrit të sigurisë

Katër nga pesë të anketuar raportuan se ndihen shumë të sigurt në shtëpitë/banesat e tyre. Nga viti 2016, 87 për qind e të anketuarve raportuan se ndiheshin të sigurt në shtëpi, duke ruajtur një trend të qëndrueshëm; Të anketuarit e rinj kanë raportuar se ndihen më të sigurt në shtëpi; Të anketuarat gra shprehën nivele pak më të larta të sigurisë në shtëpitë/banesat, lagjet dhe qytetet e tyre, në krahasim me meshkujt. Kur të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt në Kosovë një ndjenjë më e lartë e pasigurisë dhe e paqartësisë ishte e dukshme; Të anketuarit mbi 30 vjeç raportuan se ndihen më të sigurt në Kosovë sesa të anketuarit më të rinj; Të anketuarit shqiptarë dhe nga pakicat joserbe ndihen më të sigurt në Kosovë sesa qytetarët serbë.

# Policia intervenon gjatë dasmave ku përdoren armët e zjarrit



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 KORRIK - Policia e Kosovës (PK) në dy raste të ndara ka arritur t'i sekuestrojë dy armë të zjarrit të cilat janë përdorur nga persona të dyshuar, të cilët kanë përdorur armët gjatë një ahengu familjar, duke kryer veprën penale 'shkaktim i rrezikut të përgjithshëm'.

Në rastin e parë në Komunën e Suharekës, në fshatin Studenqan, pas intervenimit policor, për shkak të shkaktimit të rrezikshëm nga përdorimi i armëve të zjarrit në ahengje familjare, policia ka arritur të sekuestrojë dy armë zjarri. Arma e sekuestruar nga policia është e tipit kallashnikov AK47 dhe një karikator i zbrazur. Në rastin e dytë policia ka sekuestruar një revolver të tipit "Colt" dhe dhjetë gëzhoja të mbetura në vendin e ngjarjes. Në vendin e ngjarjes ka dalë Njësia e Krimteknikës e cila ka sekuestruar armët e dyshimta. Në lidhje me këtë rast është informuar prokurori kujdestar i Shtetit dhe rastet shkojnë në procedurë të rregullt hetimore.

Policia e Kosovës bën apel që përdorimi i armëve të zjarrit në ahengje familjare, përveç shkaktimit të rrezikshëm, përbën edhe vepër penale me pasoja, andaj kërkon të "festohet me zemër e jo me armë", me qëllim që gëzimi të mos shndërrohet në hidhërim.

# Skenderaj përkujton katër dëshmorë të kombit

SKENDERAJ, 25 KORRIK (ER) - Në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë të Skenderajt, nënkryetari i kësaj komune, Nuredin Lushtaku, drejtorë komunalë, familjarë, përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta dhe qytetarë, kanë bërë homazhe te varret e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Beqir Hajrizi me djemtë Azemin e Faikun, si dhe kushëriri i tyre Sabit Ahmetaj, në nderim të 21-vjetorit të rënies së tyre në altarin e lirisë. Po ashtu, në vendin ku kanë rënë këta dëshmorë në malet e fshatit Radishevë, është bërë edhe zbulimi i lapidarit, në një ceremoni ku kanë marrë pjesë nënkryetari Lushtaku, familjarët dhe bashkëluftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
Edhe kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, duke përkujtuar katër dëshmorët, ka theksuar se Kosova është e lirë falë sakrificës së tyre. "Për këta trima është ngritur edhe lapidari, pikërisht në vendin ku edhe kanë rënë heroikisht, në fshatin Radishevë. Dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës do t'i nderojmë gjithmonë, sepse çdo ditë e jona e jetuar në liri bëhet falë sakrificës së tyre. Lavdi e përjetshme për heronjtë e kombit!", ka thënë Jashari.



# MKRS-ja investon 2.6 milionë euro në Komunën e Gjilanit

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim kryetarin e Komunës së Gjilanit, Lutfi Hazirin. Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin në mes të MKRS-së dhe Komunës së Gjilanit si dhe u nënshkruan dy memorandume bashkëpunimi në fushën e sportit, renovimi i stadiumit të qytetit të Gjilanit dhe projekti për palestrën sportive në Zhegër të Gjilanit.
Renovimi i stadiumit të qytetit të Gjilanit është projekt në të cilin MKRS-ja do të investojë mjete financiare në vlerë prej 1 milion e 950 mijë eurosh. Ky projekt do të implementohet gjatë viteve 2019 deri më 2021.
Ndërkaq, për projektin palestra sportive në Zhegër të Gjilanit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të investojë rreth 650 mijë euro dhe projekti pritet të realizohet gjatë dy viteve 2019 e 2020.
Ministri Gashi ka vlerësuar se investimet që MKRS-ja përkrah financiarisht në kuadër të avancimit të infrastrukturës fizike po bëhen nëpër tërë Kosovën. Gashi ka thënë se me nënshkrimin e këtyre memorandume për Komunën e Gjilanit, kjo e fundit do të ketë dy objekte të rëndësishme sportive. "MKRS-ja dhe unë si ministër jemi të fokusuar që në kuadër të prioriteteve të kemi përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës sportive në Republikën e Kosovës dhe po punojmë me përkushtim që kjo gjë të arrihet", u shpreh mes tjerash ministri Gashi.
Ndërkaq kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka falënderuar ministrin Gashi për përkrahjen për komunën që ai udhëheq si dhe për projektet që u nënshkruan. Ai konsideroi se projektet në fjalë janë të mirëseardhura për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit, e në veçanti ata që merren me sport dhe sportdashësit e kësaj komune.




# Vendoset gurthemeli i shkollës së re në fshatin Vraniq të Suharekës



SUHAREKË, 25 KORRIK (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, bashkë me zëvendësministrin e Arsimit, Heset Sahitin, zëvendësministrin e Administratës Publike, Sami Hajdaraj dhe kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, kanë vënë të enjten gurthemelin për ndërtimin e të objektit të ri të shkollës "Dëshmorët e kombit", në Vraniq të Suharekës.
Limaj, me këtë rast, ka theksuar se ky është një investim i Ministrisë së Arsimit në vlerë mbi një milion euro dhe ka thënë se ky fakt tregon që Vraniqi do ta ketë një shkollë siç e meriton ky fshat, siç e meritojnë mësimdhënësit dhe nxënësit. Ai uroi që ndërtimi i shkollës të përfundojë në afatin e paraparë dhe fëmijët të kenë standarde dhe kushte për mësim cilësor. "E di që jemi vonuar me këtë projekt, por po vijmë me një investim të fuqishëm dhe shkolla e Vraniqit besoj do të jetë një nga shkollat më të mira që do t'i ketë Kosova", ka thënë Limaj, duke shtuar se ky fshat e meriton këtë investim sepse ka dhënë shumë për vendin.
Limaj ka shtuar se Vraniqi është fshat i intelektualëve, i dëshmorëve, fshat me traditë dhe histori. Ndërsa kryetari Muharremaj u shpreh mirënjohës për këto investime të rëndësishme që po i bën Ministria e Arsimit në këtë komunë.

## Filluan punimet në dy projekte të reja infrastrukturore në Klinë

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të enjten mori pjesë në fillimin e punimeve në dy projekte të reja në Klinë.
Ministri Lekaj ka thënë se rruga Ujmirë-Qupevë është dëshmi e suksesit të të zgjedhurve të popullit në zhvillim të komunave.
Kurse rruga Siqevë - Aqarevë, Lekaj, ka thënë se ka simbolikën e saj të rezistencës dhe sakrificës për liri, që ne të mund të punojmë sot në të mirë të qytetarëve të vendit. Krahas këtyre dy projekteve, ministri i bëri vizitë edhe rrethrrotullimit të përkohshëm në hyrje të Klinës, i cili redukton kolonat e gjata dhe lehtëson qarkullimin në këtë aks rrugor.
Faza e dytë e rrugës Ujmirë - Qupevë ka gjatësi afro 4.3 kilometra dhe kosto mbi 332 mijë euro, ndërsa vlera e tërë projektit është rreth një milion euro. Kurse rruga Siqevë - Aqarevë, e cila lidhë Klinën me Skenderajn, ka gjatësi prej 7.8 kilometrash me mbi 384 mijë euro. Të dy këto projekte financohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit nëpërmjet memorandumit të mirëkuptimit me komunën e Klinës.



# FOL-i me platformë online për krahasimin e pasurisë për 500 zyrtarë publikë

Lëvizja FOL ka prezantuar platformën online të krahasimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë nga viti 2010 deri në vitin 2019. Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë ekzekutive e Lëvizjes FOL, ka thënë se kjo platformë do t'u mundësojë gazetarëve, qytetarëve dhe hulumtuesve ta bëjnë krahasimin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë në mënyrë automatike, nga viti 2010 deri në vitin 2019




EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 KORRIK - Lëvizja FOL ka lansuar të enjten platformën e përditësuar për krahasimin e pasurisë për zyrtarë publikë për vitet 2010-2019. Platforma për krahasimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë përfshin rreth 500 zyrtarë të lartë publikë, ku për secilin në mënyrë individuale qytetarët e Kosovës mund t'i krahasojnë rritjen e pasurisë së tyre ndër vite, pra gjatë periudhës që kanë pasur një post publik.

Mexhide Demolli-Nimani, drejtoreshë ekzekutive e Lëvizjes FOL, ka thënë se kjo platformë do t'u mundësojë gazetarëve, qytetarëve dhe hulumtuesve ta bëjnë krahasimin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë në mënyrë automatike, nga viti 2010 deri në vitin 2019. "Përmes filtrave të ndryshëm kjo platformë ofron mundësinë e krahasimit të pasurisë për secilin zyrtar apo edhe krahasimin e pasurisë në mes të tri legjislaturave të Kuvendit të Kosovës, krahasimin e pasurisë së zyrtarëve të qeverisë nga qeveria Thaçi 2, qeveria Mustafa dhe qeveria Haradinaj", ka thënë Demolli-Nimani.

Kjo platformë u mundëson që të shihni se cilët janë dhjetë zyrtarët me rritjen më të madhe të pasurisë në tre vjetët e fundit. Përveç kësaj, platforma u shërben hulumtuesve për identifikimin e zyrtarëve të cilët kanë më shumë se një burim të të ardhurave. "Këtu vlen të theksohet se një numër i madh i zyrtarëve publikë deklarojnë se kanë aksione në kompani të ndryshme, mirëpo nuk i deklarojnë të hyrat që i marrin nga to. Njësoj vlen të theksohet edhe për shumë zyrtarë të tjerë që deklarojnë se kanë funksione në parti politike, por nuk deklarojnë të ardhura nga pozitat që i kanë në parti", ka deklaruar Demolli-Nimani.

Në këtë platformë të gjithë zyrtarët janë ndarë në katër kategori: Krerët e shtetit ku hyjnë: presidentët, kryetarët e Kuvendit, kryeministrat dhe zëvendëskryeministrat që kanë qenë nga viti 2010 deri në vitin 2019.

Në kategorinë deputet hyjnë të gjithë deputetët e tri legjislaturave të fundit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kategorinë ministra hyjnë të gjithë ministrat dhe zëvendësministrat e tri qeverive të fundit në Kosovë. Dhe kategoria e fundit është kryetarët e komunave, ku hyjnë të gjithë kryetarët e komunave që kanë qenë në këtë pozitë gjatë viteve 2010-2019.

# Ujësjellësi 'Prishtina' siguron qytetarët për cilësi të ujit të pijshëm

PRISHTINË, 25 KORRIK (ER) - Një vëllim i madh i punës dhe një kontroll ditor bazik dhe periodik bën që uji i pijshëm nga Ujësjellësi "Prishtina" të jetë i sigurt 100 për qind për konsum njerëzor. Kështu thuhet në njoftimin e kësaj kompanie.

Qëllimi kryesor i Departamentit të Cilësisë së Ujit të Pijshëm në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit "Prishtina" sh. a. është organizimi dhe funksionimi i tij si departament për kontrollin e cilësisë së ujit bazuar në standardet cilësore aplikative (U. A. 16 /2012 ) dhe ato evropiane (Udhëzimi - Direktiva 98/83/EC) mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit. "Kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjikë dhe atyre fiziko-kimikë. Aplikimi i standardeve është në interes të të gjithë konsumatorëve të Prishtinës, Fushë-Kosovës, Obiliqit, Shtimes, Lipjanit, Podujevës, Drenasit, Graçanicës dhe fabrikës së trajtimit të ujit në Shkabaj. Departamenti i cilësisë së ujit me planin e tij të monitorimit të brendshëm ka në procedurë pikë së pari mbledhjen dhe marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjellësit, operatorëve, liqeneve, puseve dhe lumenjve", është thënë në njoftimin e Ujësjellësit "Prishtina".

Sipas këtij njoftimi, laboratorët të cilët janë të akredituar shfrytëzojnë metoda standarde për parametrat të cilat janë të aprovuara nga BE-ja, sipas procedurës të cilat janë dhënë me Direktivën 98 (93) EC. "Sipas planit ditor, javor dhe mujor për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në KRU 'Prishtina' sh. a., të burimeve sipërfaqësore Albanik, Badoc, Bivolak, Mihaliq (Kanali Ibër-Lepencit), si dhe burimeve nëntokësore Kroni, Obiliq, Shtime, Lipjan, Peran (Podujevë), Miradi, Graçanicë dhe Vragoli si dhe pesëmbëdhjetë pikat në rrjetin e qytetit, në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues përcjellim kualitetin e ujit të pijshëm në çdo pikë mostrimi. Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ Nr. 16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu", thuhet në këtë njoftim.




KRU "Prishtina" ka njoftuar se numri i mostrave të ujit për pije për analizën fiziko-kimike në gjashtë muajt e ardhshëm supozohet të jetë afro 6 850 mostra të ujit. "Me monitoring të shpejtë, bazik dhe vijues çdo ditë do të bëhet mostrimi dhe analiza e ujit që prodhohet dhe distribuohet nga fabrikat e ujit në Albanik, Badovc dhe Shkabaj (Ibër-Lepenc) nga objektet prodhuese Kastriot dhe Kroni, pastaj monitorimi javor i ujit që prodhohet në objektet prodhuese Shtime, Lipjan, Drenas dhe Podujevë si dhe analiza e ujit në tre rezervuarët në qytet. Numri i mostrave të ujit për pije për analizën fiziko-kimike në vitin 2019 planifikohet të jetë afro 13.650 mostra të ujit. Paralelisht me laboratorin e akredituar të KRU 'Prishtina', sh. a. analizat bëhen çdoherë edhe nga Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës", është theksuar në njoftimin e KRU "Prishtina".

Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (3)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti Selatin NOVOSELLA

Baca Adem, të faleminderit për të gjithat!

*27 korrik 2018,*
*Gani Xharrahi, Kroacia-RDEKA*

Ishe simbol i Lirisë. I lehtë të qoftë dheu i Kosovës!

*27 korrik 2018,*
*Gjergj Lekaj*

Ju ishit themeluesi i themelit të shtetit të Kosovës, dhe rrugën që e filluat e përfunduat me sukses. Popullin e pajise me ndjenja atdhetare, kombëtare e patriotike, Ishe dhe mbete gjerë në fund besnik ndaj kombit dhe atdheut.

*27 korrik 2018,*
*Veterani i arsimit shqip,*
*Halil Mujë Dautaj*
*Nga Runiku i Skenderajt*

Lavdi e përjetshme për bacën Adem Demaçi! Nderim jetës dhe veprës se Adem Demaçit!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Lavdi jetës dhe veprës së Heroit të Kombit Bacës Adem Demaçit! Një jetë në shërbim të kombit shqiptar. Iu nderon nipi i Sefer Mikushnicës (bashkëveprimtar i çështjes kombëtare i Bacës)!

*27 korrik 2018,*
*Nipi i Rexhep Gjelit, Agim Gjeli*

Baca, Adem Demaçi, përherë do të jetë në zemrat dhe mendjet tona!

*27 korrik 2018,*
*Nebih Dakaj*

Baca, Adem Demaçi, ka dhënë çdo gjë që ka pasur mundësi për kombin.

*27 korrik 2018,*
*Rexhë Dakaj, Korishë*

Ju, Bacë jeni Heroi im! I lehtë të qoftë dheu i Koso-vës së shumëvuajtur! Do jetosh në mendjet dhe zemrat tona përherë!

*27 korrik 2018,*
*Veli Dakaj, Korish*

Respekt Bacë Adem Demaçit! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

*27 korrik 2018,*
*Sadik Pllana, Igballe Pllana*

Menduam që je i pavdekshëm Baca Adem, sa kaq shumë besuam që do të jetosh gjithmonë! Lavdi të qoftë përherë!

*27 korrik 2018,*
*Pakashtica*

Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! Lavdi, Baca Adem!

*27 korrik 2018,*
*Lulzim Basha*

Gjithë jetën Tuaj ia fale atdheut. Lavdi jetës dhe veprës suaj. I lehtë të qoftë dheu i Shqipërisë!

*27 korrik 2018,*
*I. Zhitija*

Me rastin e fundit të përshëndetjes së kolosit të patriotizmit shqiptar. I qoftë dheu i lehtë i Kosovës që e deshi aq shumë!

*27 korrik 2018,*
*Rexhep Dauti, fshati Hoxhaj, Gjilan*
*Zymer Avdyli, fshati Velekincë*

I përjetshëm kujtimi! Shembull për të gjithë ne dhe breznitë e ardhshme!

*27 korrik 2018,*
*Leonora Zefi*

Lavdi jetës dhe veprës së simbolit të qëndresës dhe rezistencës paqësore, z. Adem Demaçi! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës që aq shumë e deshe. Ne na mbetet të ndjekim rrugën tuaj.

*27 korrik 2018,*
*Valdete Idrizi*

Lavdi veprës tënde! Historikisht do të mbetesh hero i popullit shqiptar.

*27 korrik 2018,*
*Ardita Dakaj*

Lavdi jetës dhe veprës së të madhit Adem Demaçi. I qoftë i lehtë dheu i Kosovës. Baca ishte feniksi i ndërgjegjes sonë kombëtare.

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Të rrallë janë ato personalitete që gjithë jetën e vet t'ia kushtojnë kauzës kombëtare, siç qe patrioti Adem Demaçi! Lavdi punës dhe veprës së tij!

*27 korrik 2018,*
*Sami Islami*

Lavdi i qoftë jetës dhe veprës së Dajës Adem!

*27 korrik 2018,*
*Qamile Islami*

Lavdi i qoftë dajës Adem dhe veprës së tij për çë-shtjen kombëtare!

*27 korrik 2018,*
*Mbesa juaj*

Respekt jetës, veprës së burrit të madh, Adem De-maçi!

*27 korrik 2018,*
*Sokol dhe Nexhmije Gashi, Arllat*



Respekt për Bacën Adem! Do të jetë shembull për ne si brez i ri, por edhe për brezat e tjerë qo do të vijnë!

*27 korrik 2018,*
*Mirdona Bujupi*

Adem Demaçi, ky mendjelartë më shumë i ka bërë dritë e ka ngrohur shpirtin e kombit shqiptar nga errësira e qelive të burgjeve serbe, se sa vet drita e Diellit me rrezet e tij! Lavdi e përjetshme. Lavdi e përjetshme!

*27 korrik 2018,*
*Skënder Kamberaj*

Lavdi e përjetshme O Burri atdheut e i Kosovës! Qëndrove i pathyeshëm, nuk u gjunjëzove para hienave serbo-sllave, i dhe dritë të madhe Kosovës dhe kombit shqiptar. Tërë jetën ishe dhe do mbetesh i nderuar e i paharruar. Ti je ai që e bën të njohur në tërë botën!

*27 korrik 2018,*
*Hasan (mbiemri i palexueshëm), Cernicë*

Kosova mbeti pa pishtarin e lirisë! Edhe pse Baca Adem ndërroi jetë, ai mbetet i gjallë dhe i fortë. Vepra e tij do të vazhdojë të jetë udhërrëfyes i brezave që vijnë pas. I lehtë të qoftë dheu, Baca Adem, dheu i Kosovës, të cilës ia fale tërë qenien tënde.

*27 korrik 2018,*
*Shpëtim Ali Jakupi*

Baca Adem,
Ti nuk vdiqe, vetëm u ndave nga ne duke na lënë një zbrazësi që vështirë të mbulohet. Do jesh në këto troje gjithmonë, derisa ka troje e gjak shqiptar. Faleminderit për veprën tënde!
I përjetshëm kujtimi për ty!

*27 korrik 2018,*
*Muhamer Xhaferi, Bledar Xhaferi*

Fanar në furtunë,
Baca ynë i pavdekshëm, u rritem e u brumosem me shembullin tënd. Na dhe dritë kur kishim errësirë, na dhe forcë kur ajo na duhej më se shumti! Të faleminderit baca Adem! Të qoftë i lehtë dheu i Atdheut!

*27 korrik 2018,*
*Qazim Hajzeraj, Uçë, Istog*

U rrita me veprën tënde o Baca Adem! Nuk e mendoja kurrë që mund të na leni! Ti ndërrove Jetë në Ditëlindjen time! Përjetë i paharruar.

*27 korrik 2018,*
*Yll Bajraktari, Suharekë*

Pata nderin të jetojë në Epokën e Adem Demaçit - Bacës Adem, Mendeles së Shqiptarëve, njeriut i cili një jetë e shkriu për kombin, atdheun dhe liritë njerëzore. Do të jemi komb i respektuar derisa të kujtojmë veprën tënde. Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! Të kujtojmë përgjithmonë!

*27 korrik 2018,*
*Prof. Sali Ahmeti*

Baca Adem, Krenaria e Kombit Shqiptar!

*27 korrik 2018,*
*(emri i palexueshëm) Veseli*

Bacë, ishe yll polar dhe mbete dhe do të jesh gjithmonë ylli ynë prijës orientues. Përgjithmonë me ty!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Baca Adem, lavdi jetës dhe veprës suaj!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Baca Adem ishe uragan i fuqishëm që ia shembe themelet perandorisë serbo-sllave. Ishe krenaria e kombit shqiptar. Jam krenar që ta njofta shpirtin e madh. Zoti iu shpërbleftë me xhenet! Amin!

*27 korrik 2018,*
*mulla Xhevat Kryeziu, Bubavec*

Ademi ynë i madh, ti nuk vdiqe por fillove të pushosh se vepruari, për të vepruar e ndikuar vepra jote. Sot dy djemtë e mi dhe shoqja qajten me mua. Qajten Iliri e Dardani më shumë se unë, dhe kjo është edhe një dëshmi se ju do të jeni udhërrëfyes i gjeneratave të reja që vijnë.

*27 korrik 2018,*
*Xun Çetta*

Baca Adem, unë e dijë se tani pushoni i qetë. Për mua dhe familjen time ke qenë dhe do mbetesh Legjendë e gjallë. Baca Adem, të betohem se do të punojmë derisa ta bëjmë Shqipërinë Etnike!

*27 korrik 2018,*
*ish i burgosuri politik,*
*Naim Ramadani*

Qoftë i përjetshëm kujtimi për ty që ëndërr kisha të të takoj. Mirëpo kjo do të mbetet ëndrra më e mirë që kam pasur ndonjëherë, sepse ti linde për të mos vdekur kurrë.

*27 korrik 2018,*
*Sami Salihu*

Kolosi që nuk plaket kurrë! I ri e i pathyeshëm do të jetosh në zemrat tona. Lavdi jetës dhe veprës sate.

*27 korrik 2018,*
*Lumnije Isa Isufi*

Bacë, Adem Demaçi, zoti të rehatoftë në xhenet për sakrificën që bëre për Atdheun, popullin dhe për çlirimin e trojeve shqiptare dhe për bashkimin kombëtar, në një Shqipëri ashtu si e ka krijua Allahu. Vepra, sakrifica dhe vendosmëria e Bacës Adem do të jetë gjithmonë shembull dhe inspirim për të gjithë brazat për ta dashur atdheun dhe njëri tjetrin, siç na ka porositur dhe gjithmonë na porositë Zoti i Madh. Lavdi jetës dhe veprës se Heroit, simbolit të rezistencës kombëtare, Bacës, Adem Demaçi!

*27 korrik 2018,*
*Behrami - Prishtinë*

Baca, Adem Demaçi, krenaria e popullit shqiptar!

*27 korrik 2018,*
*Abdullah Mehmeti*

Baca, Adem, atdhetar i madh i kombit shqiptar, por edhe njeri i madh botëror!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Njeriu që jetoi e luftoi vetëm për liri e humanizëm për shqiptarët dhe gjithë njerëzit e botës.

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Baca Adem, jam i lumtur që kam jetuar në epokën kur veprove me dinjitetin më kulminant të njeriut prej patrioti të paepur i cili ishte sinonim i kombëtares dhe përkushtimit të përjetshëm për popullin, me sakrificë të panjohur ndonjëherë nga dikush tjetër. Ishe simbol i së mirës. Me respekt të përjetshëm për veprën tënde të madhe!

*27 korrik 2018,*
*Hajrullah Mehmeti*

**/Vazhdon në numrin e ardhshëm/**

# IKU NJË VIT KUR KALOI NË PËRJETËSI BACA I MADH, ADEM DEMAÇI



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Të verbër në mendje, të çalë në veprime: Thuhet se në këtë botë jemi kalimtarë dhe shtegtarë të rastit, por se të gjithë e kemi të përcaktuar një rol dhe një mision duke lënë një gjurmë, pozitiv a negativ, varet nga veprat që i lëmë pas. Në shumë raste gjurmët janë të përkohshme, mbesin brenda një rrethi të mbyllur familjar dhe, me kalimin e kohës, zbehen duke u shndërruar në shifra të një gjenealogjie familjare. Ndërkaq, në raste të veçanta dhe për personalitete të veçanta, veprat janë përcaktuese për përjetësinë e tyre pavarësisht prej ndryshimeve që bëhen, proceseve historike apo shoqërore nëpër të cilat kalohet, si për personalitete, vepra arti dhe kulture, zbulime shkencore e deri edhe te bota animale. Edhe këtu vlen rregulli se vepra mund të jetë negative apo pozitive, por se e fiton përjetësinë. Edhe sot flitet për Neronin. Kaligulën, Xhingis Kanin, Hitlerin, Musolinin, Stalinin, Leninin, Dr. Mengelen, Sllobodan Milloshevigin, Arkanin, Sheshelin dhe personalitete të tjera që kanë bërë shumë krime, por se janë bërë pjesë e pandashme e mosharresës njerëzore, historike, shoqërore, politike dhe morale. Flitet gjithashtu edhe për kalin e Kaligulës që u bë senator në Senatin e Romës, Gomarin e Buridanit, Gralin e Shenjtë etj. Flitet për shkak të përjetësisë edhe për veprat e Da Vinçit, veprat e Pikasos, Guernikën, Kullën e Pizas, Murin Kinez, bibliotekën e Aleksandrisë, Aja Sofia, Piarmidat në Egjipt, Kullën e Ajfelit, Kanalin Grande, Ujëvarat e Nijagaras, Statujen e Lirisë etj. Janë të pavdekshme veprat e Moxartit, Betovenit, Çajkovskit, Ravelit, Shtrausit sikur edhe interpretimet e Luçano Pavarotit, Andrea Boçellit, Edit Piaf, Domeniko Modunjos, Mirej Matje, Hulio Iglesias, Selin Dijone etj. Gjithashtu, të pavdekshëm janë edhe Gabi Markez, Paulo Koelho, Dostojevski, Tolstoj, Pushkini, Hemingueji, Tomas Man, Onore de Balzak, Servantes etj. Të paharrueshëm janë Martin Luter Kingu, Nelson Mandela, Mahatma Gandi etj. Në anën tjetër, edhe zhvillimet, proceset dhe zbulimet që kanë pasur pasoja katastrofike për njerëzimin janë bërë pjesë e përjetësisë si: Kryqëzatat, Koha e Inkuizicionit, shkatërrimi i civilizimeve dhe veprave artistike, kulturore, fetare etj. (shkatërrimi i civilizimit të Majave dhe Inkave, përndjekja e të mençurve gjatë inkuizicionit, zbulimi i dinamitit nga Alfred Nobeli, zhdukja e insianëve në Amerikë, bombat atomike mbi hiroshimën dhe Nagasakin, luftërat ballkanike dhe botërore et.). Këto që i përmenda më lart kanë karakter global, ndërsa çdo popull ka personalitete dhe procese me rëndësi lokale, rajonale dhe globale.

Shqiptarët, si një popull i vogël dhe thuaja tërë kohën i robëruar, nuk kanë pasur edhe aq shumë personalitete që e kanë vulosur kohën kur kanë jetuar dhe kanë vepruar pas së cilës janë bërë pjesë e përjetësisë. Përmenden prijësit e ilirëve si Agroni, Teuta dhe Pirroja pas të cilëve është një errësirë e madhe kohore, deri te koha e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Janë të dalluar shqiptarët që kanë kontribuar për popujt e tjerë sikur disa papë të Vatikanit, Sami Frashëri, Arkitekt Sinani, Vaso Pasha, Mbreti Faruk, Kemal Ataturku, Ismail Qemali, Hasan Prishtina etj. Ndërkaq, personalitetet kryesore që me vetëflijimin e tyre kanë siguruar përjetësinë duke u bërë pjesë e Panteonit të personaliteteve të pavdekshme botërore janë: Mësuesi, Ideologu, Strategu dhe Frymëzuesi për liri njerëzore dhe kombëtare, Baca i Madh, Adem Demaçi sikur edhe i Pavdekshmi, Komandanti Legjendar Adem Jashari. Këta janë personalitetet që e vulosën kuptimin e lirisë dhe e legjitimuan sakrificën sublime për këtë çështje duke i vënë çmim lirisë jetën e tyre, pa lënë asnjë mundësi tjetër. Investim kapital, për një qëllim kapital siç është liria dhe e drejta për të jetuar në një shtet.

Bacë Adem Demaçi në rrafshin ndërkombëtar është shpirti binjak i Nelson Mandeles, gjithmonë kur përmendet Mandela në luftë kundër aparteidit, përmendet edhe Bacë Adem Demaçi si luftëtar i pakompromis për fjalën e lirë, lirinë e shprehjes, luftën për çlirim kombëtar dhe njerëzorë sikur edhe për mbrojtjen e atyre që ishin rrezikuar për shkak të përkatësisë etnike, fetare, bindjeve politike etj.

Të shohësh me sy nuk do të thotë se nuk jeni i verbër në mendje. Edhe nëse i keni gjymtyrët e shëndosha nuk do të thotë se nuk çaloni apo nuk vendnumëroni nëse këtë gjendje nuk e shfrytëzoni për organizim, veprim dhe ecje para, drejt ardhmërisë. Është një dallim i madh midis të shohësh atë që shihet dhe të parashohësh atë që nuk duket, ta përshkruash gjendjen ekzistuese apo të parashohësh diçka që duket e padukshme dhe që, për realistët, është diçka që nuk llogaritet si normale. Pak janë ato personalitete që e kanë këtë dhunti, mbase edhe të lindur dhe kanë paguar çmim të lartë, edhe me jetë, këtë vlerë që e kanë dhe të cilën e mbrojnë në çdo kohë dhe me çdo çmim. I tillë ishte Baca Adem Demaçi prandaj në shumë raste dhe në shumë procese mbetej si "Mohikani i Fundit". Jo që nuk gjente përkrahje, por se anatemohej deri në linçim publik! Nuk mbeti kush pa e sulmuar dhe pa e dënuar; nga regjimi jugosllav dhe serb, shkaku se e këndonte këngën e lirisë në kohën kur liria kishte tjetër kuptim dhe për disa ishte robëri, kurse për disa të tjerë liri, e sulmuan dhe e kryqëzuan "demokratët e rinj" apo të konvertuarit nga Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Jugosllavisë, tash me akronimin LDK për faktin se e kundërshtonte "rezistencën paqësore të hamëshorëve të tredhur", e kundërshtuan shkaku i Rambujesë sepse tha se kjo Konferencë nuk është e duhura për shqiptarët, e sulmuan dhe "miqtë" ndërkombëtarë sepse nuk deshi ta barazojë UÇK-në me Tigrat e Arkanit duke e cilësuar si paramilitare dhe terroriste. "Shokët e burgut dhe të luftës" ia mbyllën të gjitha rrugët dhe mundësitë për ta përmbushur misionin politik dhe kombëtar duke ia siguruar margjinat, kurse për vete ndanë skenën kryesore në përpjekje të luajnë një rol kryesor, ndërkohë që u vërtetua të jenë mashtrues ordinerë dhe "artistë të çastit". Gjatë sëmundjes



mbeti kryesisht nën përkujdesje të familjes dhe të madhështores Arbërie Demaçit, ndërkohë që vizitohej nga shokët e vijës së parë të frontit që asnjëherë nuk iu ndanë, Ilmiut (Reçica), Llapqinit (Nuhi Ahemti), Dul Tarakut (Abdullah Dërgutit), Doktorit (Haki Gashit), Baralecit (Besim Baraliu), Nakut (Binak Dinaj), Zhidovit (Tahir Hani), Rrumullakut (Basri Ibrahimit) dhe derisa vdiq, edhe nga Qali (Sashivar Makolli). Të tjerët e vizituan në çaste të caktuara kur deshën që edhe nga ajo gjendje shëndetësore e Bacës të përfitojnë e që është mjerim moral dhe ndryshk njerëzor. Procesi i varrimit të Bacës Adem ishte mjerim i llojit të vet sikur edhe protagonizëm i personave të cilët për së gjalli Baca nuk i duronte afër. Pastaj, një kohë vendi ku prehet Baca i Madh i Popullit Shqiptar, Adem Demaçi, ishte shndërruar në vendparkim, pa pagesë i automjeteve dhe kamionëve kurse më vonë aty u vendosën edhe dy varre të tjera, të Ilir Konushevcit dhe Hazir Malës, pa pëlqimin e familjes, pa pëlqimin e shokëve të Bacës dhe, pa asnjë dyshim, ky veprim ishte i motivuar politikisht sikur që kishte qëllime manipulimi.

Tash, në sheshin afër Shkollës së Mjekësisë, i emërtuar Sheshi "Adem Demaçi", është paraparë të ngrehet një shtatore e Bacës Adem e cila duket të jetë e kundërta e personalitetit të Bacës. Në çdo vend normal vlerat njerëzore, kombëtare, morale dhe politike mbrohen me ligj ani pse personalitetin e vërtetë e mbron vepra. Te ne, në kohën e horrave dhe korbave bëhet e kundërta, mbrohen dhe institucionalizohen antivlerat e ndryshkura, ndërkaq margjinalizohen apo hijezohen vlerat e vërteta. Është ironi e cila përkufizohet me çmendurinë fakti se pikërisht dy figurat emblematike të shqiptarisë që i dhanë përmbajtje dhe kuptim lirisë, Adem Demaçi dhe Adem Jashari, më së shumti janë sulmuar nga vetë shqiptarët apo ata që kanë folur shqip, ndërsa kanë menduar me gjuhën e interesit material dhe personal duke mbrojtur qëndrimet e atyre që i kanë persekutuar me shekuj të gjithë ata që kanë luftuar për lirinë e popullit që i kanë takuar, por që nuk e kanë shkelur lirinë e të tjerëve. Adem Demaçi ishte, është dhe do të jetë personalitet që nuk i ka takuar askujt përveç çështjes së kauzës kombëtare dhe luftës për liri.

Askush nuk mund të ketë pronësi mbi veprën e Adem Demaçit sepse është vepër që i tejkalon këto interesa dhe vepra e Bacës Adem Demaçi është pronësi e gjithë njerëzimit, është hipotekë botërore dhe çdo përpjekje për ta individualizuar veprën dhe personalitetin e Adem Demaçit paraqet mjerim moral dhe shpërfillje të interesave kombëtare.

Në vjetorin e parë të shkuarjes në amshim të Bacës Adem Demaçi kemi një situatë kur duhet të përballemi, së pari me veten tonë, pastaj edhe me të tjerët në raport me Bacën Adem. Baca Adem është në një botë ku takohet me ata që i ka respektuar, nga të cilët është frymëzuar, prej të cilëve ka mësuar dhe me të cilët është sakrifikuar. Është bashkë me Skënderbeun, me Hasan Prishtinën, Luigj Gurakuqin, Ismail Qemalin dhe rilindësit liridashës. Është bashkë me Azem dhe Shotë Galicën, Shaban Polluzhën dhe Mehmet Gradicën, me Gjon Serreçin dhe Marie Shllakun, Rifat Berishën dhe Hoxhë Idriz Gjilanin, Shaban Shalën dhe Fazli Grajçevcin, me Dedë Gjo Lulin dhe Jakup Ferrin, me Çerçiz Topullin dhe trimat e Sulit, mr. Rexhep Malën dhe Nuhi Berishën, me Tahir dhe Nebih Mehën, me Adem, Hamëz, Shaban dhe Jasharët e martirizuar, me ata që i deshi shumë si Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, me Remzi Ademajn, Shkëzen dhe Luan Haradinajn, Hafir Shalën si dhe Xhavit Hazirin. Është me të gjithë ata që u sakrifikuan për këtë copë lirie që e kemi dhe që po e shpërdorojmë dita-ditës. Aradhes së atyre që Baca Adem i respektoi shumi iu bashkua edhe shkrimtari dhe kamxhiku kundër mashtrimit, injorancës dhe vlerave të rreme, Rexhep Hoxha.

Ka përpjekje që të minimizohet vepra dhe personaliteti i Bacës Adem Demaçi nga ata që duan të bëjnë karrierë politike, nga disa skribomanë që duan të shiten si pronarë të së vërtetës për Bacën përmes disa pamfleteve të shkruara, nga disa që duan ta pastrojnë të kaluarën e tyre të ndyrë njerëzore dhe kombëtare apo këta të tashmit që duan ta përdorin Bacën si mburojë nga punët e liga që i bëjnë. Mirëpo, është e dëshmuar se kurrë nuk ka ndodhur që luanin ta veshin me lëkurë qeni sikur që as qyqja nuk ka kënduar me zërin e bilbilit. Dhe nuk do të ndodhë!

Dikush prej shokëve, Ilmiu apo Hakiu, thanë një ditë se me ikjen e Bacës Adem në amshim na është mbyllur një derë dhe mundësi të bashkohemi. Mund të jetë edhe e vërtetë por, nëse na është mbyllur një derë, në njërën anë, në anën tjetër Baca na ka lënë një rrugë të madhe kah duhet të shkojmë në aspektin njerëzor dhe kombëtar. A jemi në atë rrugë apo, siç thoshte Baca, kemi hyrë lakrave. Secili e vlerëson për vetën e vet.

Riformatizimi i UÇK-së: Baca Adem u prish me tërë botën shkaku i UÇK-së. E mbrojti kur fasulja hahej kokërr-kokërr. Nuk mund të vepronte ndryshe sepse nuk mund ta mohonte veten dhe rrugëtimin familjar dhe personal. Se Baca Adem ishte shumë largpamës dhe parashikues tregon fakti se pas përfundimit të luftës pati thënë se "nuk do të mbetet askush pa u koritë" dhe se do të vijë një kohë që këta që kanë mbetur gjallë (luftëtarët e UÇK-së) do t'ua kanë lakmi atyre që kanë rënë në betejat e nderit. Dhe kjo kohë duket se ka ardhur. Gjykata Speciale po e bën formatizimin e UÇK-së duke i thirrur, si të dyshuar, bartësit kryesorë të luftës çlirimtare. Po e formon një UÇK të re, jo për të luftuar, por për t'i futur në burg. Madje, më shumë ushtarë dhe komandantë të UÇK-së janë ftuar para kësaj gjykate se që ka pasur në formimin e hershëm të UÇK-së. Ndoshta edhe ty, Baca Adem, Gjykata Speciale ta dërgon një ftesë. Dhe mirë bën nëse ta dërgon ftesën sepse, edhe nga varri më mirë do ta mbrosh luftën çlirimtare se disa prej tyre që i kanë lëshuar brekët para se të shkojnë në gjykatë.

Luftën çlirimtare nuk mund ta mbrojnë ata që nuk lanë pa bërë të gjitha të zezat pikërisht në emër të luftës dhe nuk e bëjnë dallimin midis erës së barotit dhe erës së m..it sepse kurrë nuk kanë qenë në luftë për ta dëgjuar erën e barotit kurse erën e m..t e kanë dëgjuar sa herë që kanë dëgjuar për luftën për faktin se i kanë mbushur brekët në mënyrë automatike. Në këto kohë pa kohë, Bacë, spiunimi dhe denoncimi është bërë mënyrë e të jetuarit dhe letër njoftimi, si nga ata që e kanë pasur traditë e që janë në të gjitha segmentet e shtetit dhe të pushtetit, deri te këta të rinjtë që, për ta shpëtuar lëkurën dhe bythën, e kanë përvetësuar këtë punë të ndyrë.

Krenarë që jetuam dhe u përpoqëm të veprojmë në kohën tënde, me mësimet tuaja, nën urdhrin tënd dhe në rrugën tuaj dhe të turpëruar nëse dalim jashtë këtyre parimeve!

Shokët tuaj që nuk t'u ndanë kurrë dhe që ende, së paku e ruajnë kujtimin për ty: Ilmiu, Binaku, Nuhiu, Duli, Tahiri, Basriu, Hakiu dhe Besimi.

Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (10)

# Efektet negative të fushave antimagnetike te njeriu



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

1. Kanë stres shumë të madh;
2. Organizmi i tyre nuk mund të rrijë i qetë dhe bëjë lëvizje të pakontrolluara;
3. Janë shumë agresivë dhe nuk e kontrollojnë situatën.

Pra, i dërgon drejt në konflikte pa asnjë shkas dhe kryejnë akte të dhunshme, rrahje, vrasje, tregojnë shumë pakujdesi në komunikacion, kurse janë njerëzit që më së shumti shkaktojnë aksidente të të gjitha formave në komunikacion dhe shumë e shumë të tjera.

Kjo mund të vërtetohet nëse shikohen raportet e ndeshjeve në komunikacion me fatalitet, vrasjet, tentim vrasjet, konfliktet.

Përpos këtyre, këto forca kanë efekt jashtëzakonisht të madh edhe në vdekjet e natyrshme, sidomos të vjetrit dhe të sëmurit nuk mund t'ju përballojnë të gjitha këtyre forcave, prandaj ndodh shumë shpesh që vdekjet e natyrshme,ndeshjet me pasoja, konfliktet të ndodhin njëra pas tjetrës, prandaj pothuajse pjesa më e madhe (jo e tëra) e të gjitha këtyre ndodhë në këto kohëra.

Këto efekte negative ndodhin shumë herë spontanisht dhe çdo kohë,por kalojnë shumë ngadalë, sepse pas ngacmimit të nervit të paktën 48 orë i duhen për t'u qetësuar, por efektet e këtyre forcave zgjasin edhe më shumë ditë dhe javë, si p.sh, shembull rreth 5 janarit, toka është më afër diellit në një distancë afër 147 093 452, kurse më 21 dhjetor 2019 dhe 14janar 2020, Hëna ndodhet në pikën më të afërt me tokën në distancën 366 057 km, kurse efektet më së shumti vërehen nga shtatori deri në Mars.

Veprimi i njëkohshëm i këtyre dy fushave antimagnetike të diellit dhe tokës në organizmin e njeriut sidomos te ata që kanë sasi të hekurit në gjak përtej normales, shkakton kaos, nervozizëm, panik, stres, hipertension.

**Parandalimi**

Vdekjeve të natyrshme nuk mund t'u bëjmë asgjë, kurse një pjesë e këtyre efekteve mund të parandalohen me kontrollimin e sasisë së hekurit (Fe) në gjak, pra njerëzit duhet të kenë kujdes, sidomos në këto kohëra.

E gjithë kjo nuk ka asnjë lidhje se a është Hëna e plotë, gjysmëhënë apo Hënë e re, kjo varet vetëm nga pozita e saj mbi kokat dhe këmbët tona.

**Efektet pozitive të fushës antimagnetike të diellit**

Fusha antimagnetike që buron nga dielli, krahas efekteve negative është e vetmja forcë që e shpërndanë energjinë e nxehtësisë dhe dritën nga dielli në drejtim të trupave të tjerë qiellorë duke e përfshirë edhe tokën të cilën e shndërron në Planet të banueshëm, por që njëkohësisht është e vetmja forcë që e parandalon eksplodimin e diellit.

Sikur të mos ishte prezentë fusha antimagnetike e diellit, temperatura nga sipërfaqja e diellit gjatë djegies së gazrave nën ndikimin e forcës gravitacionale të diellit, jo vetëm që do ta izolonte temperaturën e brendshme, por edhe do ta tërhiqte temperaturën nga sipërfaqja në drejtim të qendrës, me ç'rast temperatura do të arrinte një vlerë kritike dhe dielli do të eksplodonte ashtu sikurse ka eksploduar supernova (shih figurën 41).

**Supernova**

Eksplodimi i yjeve mund të ndodhë atëherë dhe vetëm atëherë nëse te ai yll në ndonjë formë zhduket fusha magnetike e tij nga e cila do të zhdukej edhe fusha antimagnetike, në këtë mënyrë nën ndikimin e forcës gravitacionale nxehtësia nga sipërfaqja tërhiqet drejt qendrës, duke e rritur temperaturën në gjendje kritike, atëherë ylli do të eksplodojë ashtu sikurse Supernova.

Por, falë prezencës së fushës antimagnetike, temperatura nga sipërfaqja e diellit (shih figurën 42) do të shpërndahej në të gjitha drejtimet që do të ndikonte në mosrritjen e temperaturës së brendshme të diellit dhe në këtë mënyrë do të rritej edhe jetëgjatësia e diellit.




Fig 42

## Bërthama e atomit

Edhe pse konsiderohet një ndër temat më të ndërlikuara në shkencë, struktura e atomit, ajo prapë se prapë nuk është një temë që nuk mund të diskutohet apo modifikohet.

Deshëm apo nuk deshëm, prezenca e fushës antimagnetike që buron nga një trupë qiellorë, e ka burimin nga fusha magnetike e po atij trupi gjë që do ta prekte në mënyrë të drejtpërdrejtë strukturën e atomit.

Pasi fusha antimagnetike te trupat qiellorë është e vetmja forcë që i parandalon goditjet dhe vendosë stabilitet ndërmjet trupave qiellorë, në bashkëpunim me forcën gravitacionale, atëherë edhe brenda strukturës së brendshme të atomit do ta gjejmë të njëjtën forcë që e mbanë stabile strukturën e brendshme të atomit.

Prandaj, fillojmë nga argumenti se e gjithë materia në Univers është e përbërë nga tri grimca elementare: protoni, neutroni dhe elektroni.

Bërthama e atomit përbëhet nga protonet e ngarkuara pozitivisht, neutronet që janë neutrale dhe elektronet që janë të ngarkuara negativisht.

Elektronet rrotullohen rreth bërthamës së atomit ashtu sikurse rrotullohen trupat qiellorë rreth diellit.

Për ta kuptuar më thjeshtë, cekim disa lidhshmëri ndërmjet atomit si mikro grimcë dhe diellit si makro trup qiellor.

Rreth diellit rrotullohen planetët në orbita të ndryshme njëjtë kur rreth bërthamës së atomit që rrotullohen elektronet.

Ekziston një forcë tërheqëse ndërmjet diellit dhe trupave qiellorë që rrotullohen rreth tij, pa këtë forcë planetët do të largoheshin nga dielli në pafundësi.

Forca tërheqëse e diellit, pa një forcë shtytëse, të gjitha planetët do t'i tërhiqte në brendësinë e saj dhe nuk do të ekzistonte asnjë planet që rrotullohet rreth tij.

Ngjashëm ekziston një forcë tërheqëse ndërmjet bërthamës së atomit dhe elektroneve që rrotullohen rreth tij, pa këtë forcë elektronet do të largoheshin nga bërthama e atomit në pafundësi.

Forca tërheqëse e bërthamës së atomit, pa një forcë shtytëse, të gjitha elektronet do t'i tërhiqte në brendësinë e saj, dhe nuk do të ekzistonte asnjë elektron që rrotullohet rreth tij.

Ekziston një ekuilibër i forcave të barabarta ndërmjet forcave shtytëse dhe tërheqëse sikur te trupat qiellorë ashtu edhe te atomet.

Forca shtytëse te trupat qiellorë, edhe pse askush deri sot nuk e ka cekur përveç meje, ajo është fusha antimagnetike e po atij trupi që posedon fushë magnetike.

Me rëndësi është të bazohemi në forcën repulsive në Univers që e mbanë stabil Universin, vetëm duke u bazuar në fushën antimagnetike që e ka burimin nga vetë fusha magnetike e atij trupi qiellor, atëherë mund ta gjejmë një lidhshmëri mbi prezencën e kësaj force brenda atomit e cila është forca kryesore që e mbanë stabil strukturën e tërësishme të atomit.

**Protoni**

Vërejtje: Edhe pse numri i kuarteve sipas ekspertëve të sotëm mund të jetë më i lartë se ky numër prej tre kuarteve, sipas fenomenit të lindjes së fushës magnetike, i marrim për bazë vetëm tri kuarte.

Protoni është një grimcë e ngarkuar me elektricitet pozitiv dhe përbëhet zakonisht nga dy kuarte (quarks) lart (up) dhe një kuart (quarks) poshtë (down) (2/3 u) lart (up), (2/3 u) lart (up) dhe (-1/3 d) poshtë (down).

Pasi protoni është një ngarkesë pozitive, shtrohet pyetja se pse është ngarkesë pozitive, nga i vjen kjo ngarkesë dhe kush është shkaktar i kësaj?

Bazuar në strukturën e tokës, e cila përbëhet nga materialet feromagnetike hekuri (Fe), nikeli (Ni), dhe kobalti (Co), mund të themi se struktura e brendshme e protonit përbëhet nga dy kuarte (2/3 u) dhe (2/3u), që kanë vlerë pozitive dhe një kuart (1/3 d), i cili ka vlerë negative.

Sasia e hekurit (Fe) është shumë herë më e madhe se sasia e nikelit brenda strukturës së brendshme të Tokës, ngjashëm edhe te protoni, sasia e kuarteve (2/3 u) dhe (2/3u) është shumë më e madhe se e kuarteve (-1/3 d).

Një përzierje e hekurit (Fe) dhe nikelit (Ni) përmes fenomenit të tornados elektromagnetike (aX+aY) e krijon rrymën e elektrike, nga e cila formohet fusha magnetike ((B)) ?.

Prandaj, brenda protonit duhet të ekzistojë një fenomen i tornados (aX+aY) që i përzien kuartet pozitive (2/3 u) (2/3 u) me kuartet negative (-1/3 d) prej nga protoni do të ngarkohej me elektricitet pozitiv.

Pa këtë kusht nuk mund të kemi një ngarkesë pozitive te protoni as negative te elektroni, sepse te një gjenerator nëse kemi të njëjtin rrotullim të rotorit dhe statorit, ai nuk do të prodhojë rrymë. Kushti i vetëm që të prodhojë rrymë gjeneratori është atëherë dhe vetëm atëherë kur njëri element rrotullohet me shpejtësi të ndryshme brenda tjetrit, qoftë rotori brenda statorit apo statori rreth rotorit.

Ngjashëm sikur te toka apo dielli, fenomeni i tornados brenda strukturës së brendshme të protonit e bënë përzierjen e njërit kuart pozitiv (2/3 u) me njërin nga kuartet negative (-1/3 d) ku sasia e kuartit me vlerë pozitive është shumë më e madhe se ajo e kuartit me vlerë negative.

**Vijon.**




Eksplidimi i DIELLIT
SUPERNOVA Diellore

Fig 41

## Barnier: Kërkesat e Johnsonit për Brexit, të papranueshme



Bruksel, 25 korrik - Kërkesat për ndryshime të marrëveshjes së ndarjes të kërkuara nga kryeministri i ri britanik, Boris Johnson, janë të papranueshme dhe BE-ja duhet të përgatitet për një dalje të Britanisë së Madhe pa marrëveshje, paralajmëroi të enjten negociatori i Bashkimit Evropian, Michel Barnier. "Boris Johnson deklaroi se nëse do të ketë një marrëveshje, atëherë duhet të eliminohet valvuli i sigurisë - çështja e kufirit irlandez. Është dukshëm e papranueshme dhe nuk përkon me mandatin e Këshillit Evropian", theksoi Michel Barnier në një letër që iu drejtohet 27 shteteve të Unionit.

# Boris Johnsoni nis mandatin si kryeministër i Britanisë

**Pas marrjes së detyrës së re, kryeministri i ri i Britanisë, Boris Johnson, nisi organizimin e ekipit të tij politik qysh të mërkurën që përfshin për herë të parë një sekretar të Thesarit që vjen nga pakicat si dhe disa gra. Dita e parë e punës e kryeministrit Johnson u shënua me tubime si nga përkrahësit, ashtu edhe nga kundërshtarët e tij**



Londër, 25 korrik - Kryeministri i ri i Britanisë, Boris Johnson, që është njëkohësisht udhëheqës i Partisë Konservatore, nisi organizimin e ekipit të tij politik qysh të mërkurën kur edhe mori detyrën e re. Kabineti i ri përfshin për herë të parë një sekretar të Thesarit që vjen nga pakicat si dhe disa gra. Dita e parë e punës e kryeministrit Johnson u shënua me tubime si nga përkrahësit, ashtu edhe nga kundërshtarët e tij.

Qendra e Londrës u mbush me demonstrues teksa Britania i dha lamtumirën Theresa May dhe mirëpriti Boris Johnson në postin e kryeministrit të 55-të të vendit, ka njoftuar voa.

Një grup protestuesish u përpoqën t'i presin rrugën shefit të ri të ekzekutivit derisa ai shkonte drejt Pallatit Buckingham për një takim ceremonial me mbretëreshën.

Pa humbur kohë, kryeministri i ri formoi qeverinë e re që do ta ndihmojë të nxjerrë Britaninë jashtë Bashkimit Evropian më 31 tetor. "Ndonëse kam një ekip të mrekullueshëm, personalisht marr përgjegjësinë për ndryshimet që dua t'i shoh. Harrojeni të kaluarën. Përgjegjësia është jona", tha kryeministri i ri britanik. "Mezi pres të punoj me ekipin e kryeministrit të ri, i cili tashmë i ka vendosur përparësitë e tij kryesore. Ato përfshijnë largimin nga Bashkimi Evropian më 31 tetor dhe përfitimi nga mundësitë e mëdha ekonomike që kemi përpara", tha Sajid Javid Sekretari i ri i Thesarit.

Në vend të Javid si sekretar i Brendshëm, kryeministri Johnson ka emëruar ish-sekretarin e Jashtëm për Zhvillimin, konservatorin Priti Patel, i cili u detyrua të dorëhiqej nga qeveria May, pas daljes në dritë të njoftimeve për takimet e fshehta të saj me qeverinë izraelite.

Ish-rivali i Johnson, Jeremy Hunt, u zëvendësua nga Dominic Raab si sekretar i Jashtëm dhe sekretar i parë i Shtetit. "Është e qartë se mesazhi që Ministria e Jashtme dërgon rreth mundësive në botë dhe besimit që ne kemi te vendi ynë, janë diçka që unë mezi pres të përfshihem", tha sekretari i ri i Jashtëm Raab.

Aleati i vjetër i kryeministrit, ish-ministri i Sigurisë, Ben Wallace, u emërua sekretar i Mbrojtjes, duke zëvendësuar Penny Modaunt. Disa prej anëtarëve të kabinetit u konfirmuan në pozitat e tyre gjatë riorganizimit të qeverisë, mes tyre sekretari për çështjen Brexit, Stephen Barclay dhe ai i Shëndetësisë, Matt Hancock.

# Rritet presioni ndaj kandidatëve opozitarë para zgjedhjeve në Moskë



Moskë, 25 korrik - Një gjykatë në Rusi ka dënuar politikanin Aleksei Navalny me 30 ditë burgim në kuadër të masave shtypëse për liderët opozitarë para se të mbahet një protestë e paautorizuar këtë fundjavë.

Dënimi i Navalnyt vjen në kohën e bastisjeve që po kryen policia në shtëpitë e kandidatëve opozitarë për ulëse të Këshillit të qytetit të Moskës, Dmitry Gudkov, Ivan Zhdanov dhe Aleksandr Solovyov. "Rreth 10 zyrtarë policorë kanë kërkuar në shtëpinë tonë. Unë jam në Bullgari me djalin tim dhe ata nuk janë duke lejuar Dmitry Gudkov që të më kontaktojë. Policia është duke kërkuar material për aksionin e 27 korrikut", ka shkruar gruaja e Gudov, Valeriya në rrjetin social, "Twitter".

Yulia Galyamina dhe Sobol Lyubov, dy kandidatë të tjerë që po kërkojnë ulëse në këshill, kanë thënë se Komiteti Hetues i Rusisë ka kërkuar që t'i intervistojë.

Liderët opozitarë kanë bërë thirrje për organizimin e një marshi më 27 korrik për ta protestuar vendimin e Komitetit Zgjedhor të Moskës, i cili ka kundërshtuar që t'i regjistrojë kandidatët e pavarur në zgjedhjet për Këshillin e qytetit të Moskës që mbahen në muajin shtator.

Ky marsh nuk ka marrë autorizimin e qeverisë.

Gennady Gudkov ka thënë se autoritetet frikësohen nga protesta e njerëzve.

Në Rusi janë shtuar shenjat për rritje të lëvizjeve protestuese dhe duket se standardet e jetesës dhe të drejtat civile kanë ndikuar në këtë situatë.

Më 20 korrik rreth 20 000 persona ishin mbledhur në Moskë për të kërkuar zgjedhje të lira dhe të drejta.

## Koreja e Veriut lëshon dy raketa në det




Seul, 25 korrik - Një zyrtar i mbrojtjes i Koresë së Jugut tha se Seuli po ndjek nga afër lëvizjet e Koresë së Veriut pas lëshimit të dy raketave në det nga Peniani të enjten. Lëshimi i raketave duket se ka për qëllim forcimin e pozitave të Penianit në bisedimet bërthamore me Shtetet e Bashkuara.

Ushtria e Koresë së Jugut tha se raketat u lëshuan nga një objekt pranë qytetit lindor Wonsan të Koresë së Veriut. "Kohët e fundit Kim Jong Un vizitoi një zonë pranë vendit nga u bënë lëshimet dhe mori pjesë në aktivitete publike", tha Kim Jun-rak, zëdhënës i Shtatmadhorisë së Koresë së Jugut.

Javën e kaluar Koreja e Veriut la të kuptohet se Peniani mund ta rifillonte lëshimin e raketave balistike dhe provat bërthamore nëse Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Jugut nuk i ndalnin manovrat e përbashkëta ushtarake të planifikuara.

Presidenti Donald Trump dhe udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, u takuan muajin e kaluar në zonën e çmilitarizuar që ndan dy Koretë, ku ata ranë dakord t'i rinisnin bisedimet.

E rrallë

# Lokali 104-vjeçar shpallet më i miri në botë



Caffe Dante është hapur në fshatin Greenwich në vitin 1915, një ndërtesë e frekuentuar nga emigrantët italianë. Kafja historike u rihap në vitin 2015 nga pronarët aktualë, australianët Linden Pride dhe Natalie Hudson. Vetëm disa vjet pas rilindjes së saj, Dante ka arritur përsosmëri në një shkallë globale. Në fundjavë u emërua nga Tales of the Cocktail Foundation si lokali më i mirë në botë dhe bar restoranti më i mirë në Amerikë në 2019 Spirited Awards që u mbajt në New Orleans.

FOTO E DITES



Mbretëresha Elizabeth II mirëpret Boris Johnsonin gjatë një audience në Buckingham Palace përpara se ta njihte zyrtarisht atë si kryeministrin e ri të Britanisë. /Reuters/

E jashtëzakonshme

# Dënohet me burg nëna që adoptoi 118 fëmijë



Një grua 54-vjeçare në Kinë është dënuar me 20 vjet burgim për mashtrim. Li Yanxia njihet si filantrope për adoptimin e 118 fëmijëve. Ajo u shpall fajtore në Gjykatën e Wu'an në provincën Hebei të mërkurën për grabitje, mashtrim, falsifikim dhe shqetësim të rendit. Ish-pronarja e jetimores, me nofkën "Love Mother", u gjobit gjithashtu me 388 000 dollarë.

## BARSOLETA E DITËS



**"Jam i shqetësuar që ime shoqe kalon mbrëmjen nga një bar te tjetri", thotë njëri.**
**"Mos ka vesin e keq që pi shumë?", e pyet tjetri.**
**"Jo, more jo, po ka vesin të bredhë e të më gjejë mua me ndonjë vajzë".**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC




**Nga dita e diele ne ora 14:00 dhe 18:00**

### "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts




**Nga dita e diele ne ora 22:00**

### "STUBER"

Aksion/Komedi; 1 orë 33 min

**Rolet:** Kumail Nanjiani, Dave Bautista, Iko Uwais, Natalie Morales, Betty Gilpin, Jimmy Tatro, with Mira Sorvino, and Karen Gillan

**Regjia:** Michael Dowse

**Në ora 20:00**

### "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver
**Regjia:** Jon Favreau







**Nga dt. 08.08.2019**

### "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Edhe pse ju kanë dalë disa probleme të vogla financiare kohët e fundit do të arrini të zgjidhni gjithçka. E rëndësishme është t'i ndani prioritetet.



**DEMI**
Kjo nuk është dita juaj dhe jeni gjithë kohës nën stres. Do të mundoheni t'i menaxhoni emocionet, por shumë e vështirë të ndodhë.



**BINJAKËT**
Jeni të rrethuar nga njerëz pozitivë dhe që mendojnë vetëm për të mirën tuaj. Kjo gjë ju shtyn të vepronit më të sigurt.



**GAFORRJA**
Ditën e sotme keni nevojë për siguri. Këtë gjë do ta kërkoni si nga kolegët e punës, ashtu edhe nga partneri.



**LUANI**
Një ndjesi plogështie do t'ju shoqërojë sot gjatë gjithë ditës. Është mirë të bëni një kontroll për të parë që çdo gjë shkon mirë me fizikun tuaj.



**VIRGJËRESHA**
Edhe pse ju duket sikur të tjerët nuk do t'ju vijnë në ndihmë sot për një problem të caktuar, gaboheni. Miqtë tuaj do të jenë aty për ju.



**PESHORJA**
Një debat i ndezur me partnerin që në orët e para të mëngjesit do t'i ketë pasojat e tij përgjatë gjithë ditës së sotme.



**AKREPI**
Do t'ju thonë një të vërtetë të hidhur sot që do të parapëlqenit të mos e dinit. Respekti për një person do t'ju humbë përgjithmonë.



**SHIGJETARI**
Keni nevojë për qetësi këto kohë për të menduar më mirë dhe më kthjellët ndryshimet e mëdha që doni të realizoni.



**BRICJAPI**
Merrni kohë në dispozicion për t'iu përkushtuar interesave tuaja dhe familjes. Do të shikoni që ju mungonin këto çaste kënaqësie.



**UJORI**
Sot mbase do t'ju tërheqë një ndjenjë e çastit që do të tregojë më të ardhmen se është shumë më e fortë sesa që e mendonit.



**PESHQIT**
Sot keni probleme përqendrimi sepse doni të zgjidhni disa punë njëherësh. Në fund të ditës do të përfundoni duke shkatërruar gjithçka.

# Kim Kardashiani del kundër fotografit të vet personal



Kim Kardashian ka thyer heshtjen për pretendimet e fundit rreth fotografit të vet personal Marcus Hyde për të cilin thuhet se i ka ofruar falas një fotosesion një modelueses në këmbim të disa fotografive nudo. "I kam lexuar të gjitha rrëfimet nga gratë rreth sjelljes së papërshtatshme dhe të pafalshme të fotografit me të cilin kam punuar në të kaluarën. Unë qëndroj në përkrahje të plotë për të drejtën e çdo gruaje që të mos ngacmohet apo t'i bëhet presion për të bërë diçka që nuk i pëlqen", ka shkruar Kim në postimin e vet në llogaritë sociale.

# Për hir të të birit Sophia Loren rikthehet në ekran





Për hir të të birit, Edoardo Ponti, Sophia Loren, në moshën 84-vjeçare i kthehet ekranit. Dhe këtë e bën për një film që po xhirohet këto ditë në Pulia, mes Barit, Tranit dhe Pstunit, "Jeta përballë meje", bazuar në romanin me të njëjtin titull të Roman Gary. Filmi është, në fakt, një rikthim i një metrazhi të gjatë të vitit 1978, Madamë Roza, të kineastit izraelit Moshe Mizrahi, me protagonist Simone Signoret dhe parashikohet të dalë në kinema në pranverën e 2020-s.







# Bebe Rexha dhe Dua Lipa sërish garojnë në të njëjtën kategori në MTV Awards 2019

MTV ka shpallur zyrtarisht nominimet për "MTV Video Music Awards 2019". Ariana Grande dhe Taylor Swift dominojnë me nga dhjetë nominime secila, në kategoritë e rëndësishme duke përfshirë "Videoja më e mirë e vitit", "Kënga më e mirë e vitit" dhe "Kënga më e mirë e zhanrit pop". Shfaqja e çmimeve është paraparë të mbahet më 26 gusht, në orën 20:00 (sipas orës lokale në ShBA). Ngjarjet e ndryshme botërore nuk kanë se si bëhen pa shqiptarë, artistet Dua Lipa dhe Bebe Rexha edhe në MTV VMA 2019, kanë përfunduar të nominuara në të njëjtën kategori: "Kënga më e mirë elektronike".

# Reperi amerikan dënohet me 55 vjet burgim



Reperi amerikan Tay-K është dënuar me 55 vjet burgim si dhe 21 mijë dollarë gjobë. Vendimi është marrë nga një gjykatë e Teksasit. 19-vjeçari u dënua për një vrasje të ndodhur në vitin 2016 dhe tri grabitje të dhunshme. Taymor McIntyre u gjet fajtor për vrasjen e Ethan Walker, 21 vjeç, së bashku me gjashtë persona të tjerë, të cilët ishin organizuar për të grabitur para dhe drogë në shtëpinë e viktimës. Tay-K ka pohuar se nuk ishte ai personi që kishte shkrepur armën, por gjykata e hodhi poshtë pretendimin e tij.





Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Zeka: Kualifikimi është obligim i Feronikelit

Mevlan Zeka, autor i dy golave në Ligën e Kampionëve në këtë edicion, ka thënë se Feronikeli e ka obligim ta fitojë ndeshjen e kthimit ndaj Slovan Bratislavës dhe të kualifikohet në rrethin e tretë të Ligës së Evropës. "Asgjë nuk është e pamundur, sepse tash të gjithë dinë të luajnë futboll. Besoj shumë se në ndeshjen e kthimit te kemi përkrahje të madhe dhe do të luajmë për fitore e kualifikim. Nuk kemi çfarë të kalkulojmë dhe fitorja është obligimi ynë në ndeshjen që e luajmë si vendës", ka deklaruar Zeka



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 KORRIK - Feronikeli e humbi ndeshjen e parë të rrethit të dytë në Ligën e Evropës nga Slovan Bratislava (2-1), por kjo nuk e pengon sulmuesin Mevlan Zeka të krenohet me paraqitjen e futbollistëve kampionë të Kosovës në Sllovaki. Ai ka thënë të enjten për "Epokën e re" se paraqitja ishte e mirë ndaj një skuadre të fortë siç është Slovani, e cila ka përvojë të madhe në ndeshjet ndërkombëtare", ka thënë Zeka. Sulmuesi që në ndeshjen e zhvilluar të mërkurën është inkuadruar në lojë në pjesën e dytë foli edhe për ndeshjen e kthimit që zhvillohet më 30 korrik në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Zeka është shumë optimist se "Nikli" do të kualifikohet në raundin e tretë të Ligës së Evropës. "Asgjë nuk është e pamundur, sepse tash të gjithë dinë të luajnë futboll. Besoj shumë se në ndeshjen e kthimit te kemi përkrahje të madhe dhe do të luajmë për fitore e kualifikim. Nuk kemi çka të kalkulojmë dhe fitorja është obligimi ynë në ndeshjen që e luajmë si vendës", ka deklaruar Zeka. Skuadra e Feronikelit, pas paraqitjeve superiore në Kosovë, ku arriti të triumfojë në garën për titull dhe Kupë, është paraqitur mirë edhe në garat ndërkombëtare. Kjo skuadër fillimisht mposhti Lincoln Red Imps FC (1-0), kurse më pas e mposhti edhe FC Santa Coloma (2-1), ani pse një pjesë të madhe të ndeshjes e luajti pa një lojtar. Feronikeli në përballje me The New Saints në Uells luajti 2-2, kurse në ndeshjen e kthimit pësoi humbje në "Fadil Vokrri" me rezultat 0-1.

### Tifozët e Feronikelit iu kundërpërgjigjen tifozëve sllovakë

Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Sllovaki, tifozët vendës nuk janë treguar aspak miqësorë me Feronikelin, pasi kanë shfaqur banderola me mbishkrimin se Kosova është Serbi. Kjo i ka irrituar tifozët e Feronikelit, "Tigrat e Zi", të cilët kërkojnë mbështetjen e të gjithë tifozëve shqiptarë. "Të gjithë për 'Niklin', të gjithë për Shqipërinë. Kosova është Shqipëri", shkruajnë tifozët e Feronikelit.

## KUKAJ LARGOHET NGA DARDANA

PRISHTINË, 25 KORRIK - Mbrojtësi i njohur në Kosovë, Liridon Kukaj, përfundimisht është larguar nga skuadra e Dardanës. Lajmin e ka konfirmuar për "Epokën e re" vetë mbrojtësi që ka luajtur një pjesë të madhe të karrierës për Prishtinën. "Me Dardanën e kam përfunduar marrëveshjen, kurse tash jam në kontakt me disa skuadra të Superligës dhe Ligës së Parë", ka thënë Kukaj, i cili ka bërë karrierë edhe në Shqipëri.



# Kosova me fitore e mbyll Kampionatin Botëror

**Prishtinë, 25 korrik** - Përfaqësuesja U21 e Kosovës në hendboll me fitore të lartë e ka mbyllur pjesëmarrjen në Kampionatin Botëror në Spanjë. Është kjo hera e parë që një ekip përfaqësues i Kosovës në sportet ekipore ka arritur të kualifikohet në botëror. Kosova të enjten në Pontevedra u takua me Australinë dhe fitoi me rezultat bindës 38:20. Pjesa e parë përfundoi me rezultatin 21:9 për "Dardanët". Dallimi në cilësi ishte shumë i madh dhe kështu Kosova herët krijoi epërsi të lartë dhe arriti pa vështirësi te fitorja bindëse, kurse ndeshja ishte për vend të 23-të. Kosova kishte siguruar biletën e fundit për botëror, ndërsa në Spanjë la përshtypje shumë të mirë në ndeshjen e parë me Kroacinë, ndaj së cilës ishte rivale e barabartë. Grupi i Kosovës ishte shumë i fortë dhe kështu kalimi i tij me sukses ishte vështirë i arritshëm. Pos me Kroacinë, Kosova ka humbur edhe ndaj Hungarisë, Portugalisë dhe Brazilit. Në fund barazoi me Bahrejnin për pikën e parë në botëror. Të mërkurën djemtë tanë nuk e kishin ditën dhe humbën nga Argjentina në ndeshjen e parë për plasman. Të enjten ndaj Australisë ishin bindës. Për nga cilësia, Kosova qëndron më mirë se 4-5 kombëtare që do të renditen më lart se ne. Por mungesa e përvojës në këtë nivel dhe grupi i fortë kanë bërë të veten. Po ashtu, edhe sistemi i garës dhe paraqitja jo në nivelin e synuar në disa takime. Gjithsesi botërori është përvojë me rëndësi për këta djem e, po ashtu, për hendbollin dhe sportin kosovar në përgjithësi. Të kujtojmë që në Spanjë jemi prezantuar me të gjitha simbolet. Himni shtetëror është intonuar para çdo ndeshje e, po ashtu, flamuri shtetëror i Kosovës është i shfaqur në palestrat në Pontevedra dhe Vigo. Ndaj Australisë lojtar i ndeshjes u shpall Albin Xhafolli.



Australia - Kosova 20:38 (9:21)
Kosova: Luzha, Gubetini 2, Dugolli, Abazi, Bajqinovci 1, Shabani 2, Avdulli 3, Tahirukaj 3, Mustafa 6, Beqiraj, Muqolli 3, Xhafolli 8, Basholli 6, Halili 2, Dalladaku 2.

## Ramadani, afër medaljes në 'Baku 2019'



PRISHTINË, 25 KORRIK - Muhamet Ramadani është kualifikuar në finale të garave të atletikës në disiplinën hedhje e gjyles në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Ramadani hodhi gjylen pesë kilogramë në largësi 18.51 metra, që i mjaftoi për t'u kualifikuar në finale. Në grupin e vet ai zuri vendin e parë, ndërsa në të dyja grupet doli i treti. Sipas trajnerit të tij, Xhavit Tahiri, qëllimi ishte vetëm kualifikimi në finale që, sipas tij, ky nuk është maksimumi i Muhametit. Ramadani do të garojë të premten në finale, ku do ta synojë medaljen.

## Renditja e FIFA-s, Kosova dhe Shqipëria shënojnë ngritje

PRISHTINË, 25 KORRIK - FIFA e ka publikuar renditjen më të re të kombëtareve, kurse Kosova dhe Shqipëria kanë shënuar rritje në këtë renditje. Kosova është ngritur për një pozitë më lart në krahasim me muajin e kaluar dhe tash "Dardanët" janë në vendin e 120 me 1149 pikë. Në anën tjetër, Kombëtarja e Shqipërisë është ngritur për dy pozita. Muajin e kaluar kuqezinjtë ishin në pozitën e 66, kurse tash renditen në pozitën e 64-t. Belgjika vazhdon të jetë e para në këtë renditje, kurse vendin e dytë e ka rrëmbyer Brazili që triumfoi në Kupën e Amerikës. Në vendin e tretë është kampioni i Botërorit, Franca.



# Hajrizi: Japim maksimumin në çdo ndeshje

PRISHTINË, 25 KORRIK - Basketbollistët e Kosovës po vazhdojnë me stërvitje dy herë në ditë në përgatitjet për parakualifikimet e "Eurobasket 2021". "Dardanët" do të përballen me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe, ku fituesi i grupit kualifikohet tutje. Kosova ka zhvilluar dy ndeshje miqësore me Sllovakinë, derisa do të zhvillojë edhe dy me Shqipërinë, të premten dhe të shtunën, për t'u përgatitur sa më mirë.

Basketbollisti i Kosovës, Drilon Hajrizi, ka folur për rrjedhën e përgatitjeve. "Mund të them se përgatitjet po shkojnë ashtu siç kemi planifikuar dhe po japim maksimumin edhe në stërvitje për t'u përgatitur sa më mirë. Nuk kemi shumë kohë, andaj duhet të përgatitemi 100 % deri para ndeshjeve me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe. Atmosfera në ekip është shumë e mirë dhe shpresoj të mos kemi lëndime", deklaroi Hajrizi për faqen zyrtare të FBK-së.

Basketbollisti mitrovicas vlerësoi se ndeshjet miqësore janë shumë të rëndësishme. "Kemi zhvilluar dy me Sllovakinë, derisa do t'i zhvillojmë edhe dy me Shqipërinë. Këto ndeshje na ndihmojnë t'i përmirësojmë gabimet dhe të fokusohemi 100 % për ndeshjet parakualifikuese", ka shtuar ai.



Ndeshjet miqësore ndaj Shqipërisë do të zhvillohen të premten (19:00) dhe të shtunën (19:00) në Prishtinë. Takimet zhvillohen me dyer të mbyllura. Në fund, ai foli edhe për gjasat e Kosovës për kualifikim. "Ne do ta japim maksimumin në çdo ndeshje. Në shtëpi do ta kemi përkrahjen e publikut, që na ka mbështetur gjithmonë, por duhet të fitojmë edhe si mysafirë për t'u kualifikuar. Britania ka një ekip të mirë, por ne nuk do të dorëzohemi dhe do të luajmë për fitore në çdo ndeshje", përfundoi Drilon Hajrizi.

Ndeshjet parakualifikuese zhvillohen nga 3 deri më 21 gusht.

# Vetteli synon ta thyejë mallkimin në pistën e Hockenheimit

HOCKENHEIM, 25 KORRIK - Një vit më parë në pistën e Hockenheimit piloti gjerman Sebastian Vettel bënte gabimin më të madh të karrierës, duke dalë jashtë pistës teksa kryesonte garën, duke "dorëzuar" edhe titullin kampion. Ndaj piloti i Ferrarit shpreson që këtë herë të bëjë autokritikë në garën e shtëpisë së tij, për ta korrur suksesin e parë sezonal. "Jemi të detyruar të bëjmë një garë më të mirë krahasuar me vitin e kaluar. Të paktën kjo gjë vlen për mua. Ndaj, mezi pres të zbres sërish në pistën e Hockenheimit", u shpreh piloti gjerman i "kokëkuqes".

Pista e Hockenheimit është vetëm pak kilometra larg shtëpisë së Vettel, por ai nuk ka triumfuar kurrë, ndaj katër herë kampioni i botës në Formula 1 shpreson ta thyejë tabunë. "Këtu gjithnjë atmosfera është e jashtëzakonshme dhe shpresoj që këtë herë të mos i zhgënjej fansat e mi. Dua patjetër një tore këtu", ka thënë Vetteli. "Kjo është një pistë që kërkon shumë kujdes, ka disa kthesa delikate, sidomos e para, që të krijon vështirësi në manovrim. Shpresoj që të ndihem mirë me Ferrarin që në provat e lira, në mënyrë që të jemi të shpejtë dhe fitojmë", ka deklaruar Vetteli.



## SHKURT

### Festim Beqiri dhe Fationa Kasapi përfundojnë garat në 'Baku 2019'

Festim Beqiri mbylli garat e xhudos në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Xhudisti i Kosovës u mposht në repesazh nga garuesi vendës, Matin Rzazade (Azerbajxhan), kategoria -66 kilogramë. Arritja në 12 më të mirët në kategorinë e tij është sukses për Beqirin. Ndërsa edhe Fationa Kasapi nuk arriti ta vazhdojë rrugën drejt medaljes në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Xhudistja e Kosovës, përkundër se dha maksimumin deri në fund, u mposht nga sllovenia Tjasa Rosman Muha në raundin e parë të kategorisë -57 kilogramë.

### Leon Thaqi përmirësoi rekordin personal

Edhe atleti tjetër Leon Thaqi garoi sot në disiplinën 800 metra vrapim në garat e Festivalit Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Leoni ishte konkurrent i denjë me garuesit e tjerë, duke mos pasur dallim të madh. Ai pati kohën 1:59.76, duke dalë i 14-ti nga 16 garues. Sipas trajnerit Xhavit Tahiri, ashtu sikurse Diellza Selaci, Leoni ka përmirësuar rekordin e tij personal për katër të qindtat e sekondës.

### Kloppi e mohon se Coutinho do të rikthehet në Liverpool

